



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XII i botimit, nr. 147, janar 2016

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

PO AFRON 100 VJETORI I SHKOLLËS SË PARË SHQIPTARË DUKAGJIN 2



PROFESOR MILL (MICHAEL) MARKU Dukagjinasi i pare i shekullit te kaluar i laureuar për histori dhe arte në SHBA 3

Nga Prelë Milani

Gojarisht në mënyre te pa të konfirmuar me ndonjë dokument, ka kohë që kam dëgjuar disa emigrant shqiptare te flasin me konsiderata te larta për një intelektual te shquar i lindur në Dukagjini në përfundim të Luftës së Pare Botërore, i arsimuar në Itali, emigruar prej andej në SHBA, ku ka fituar edhe titullin e Profesorit dhe duke lenë shume në fushën e letrave. Duke qenë, se personi në fjalë ka vdekur në mesin e viteve gjashtëdhjetë, kur nuk kishte as një komunikim mes vendlindjen dhe brezat e sotëm kishin dëgjuar shumë përciptas gojëdhëna, që tregoheshin dhe që ishin kontradiktore...



MEHMET SHPENDI, ORGANIZATORI I "DJELMNISË SË SHALËS", I PARI FORMACION I ORGANIZUAR I RINISË SHQIPTARË 4

Shekuj më parë, kur princit Gjin Tanushi ju dha titulli "Dukë", Principata e Arbrit mori emrin Dukagjin, e cila në shekullin e XV e udhëhequr nga Lek Dukagjini u bë shumë e fuqishme, e dyta pas Kasriotëve...

LAMUMRË NDUE ÇUKELI

Atë që nuk e bëmë ne, të gjallët jam i bindur se sonte do ta bëjnë gjyshërit dhe etërit tanë!

Të nderuar familjare, miq, shoke, koleg, dashamire të njohur, autoritete publike dhe fetare! Jemi mbledhur pa dëshirë në këtu vend të bekuar në prag ndërrimit të moteve, Jemi mbledhur këtu sot pasi vullneti i Krijuesit tonë të gjithë pushtetshëm thirri pranë vetes, njeriun e mire, patriotin e dëlirë, intelektualin kurajoz, ushtarakun e talentuar veprimtarin për të pa lodhur, ...



PER AVIATORIN NDUE LOGU

Pjesë nga libri "Shqiponja e Qiellit" kushtuar deshmorit te atdheut Ndue Logu, shkruar nga GJIN MUSA

Ajo ishte një ditë si gjithë të tjerat. Një ditë e mezit të torit, me një diell që me kalimin e orëve fillonte e ngrohte me shumë. Në poligonin e qitjes në Farkë të Tiranës ishte një ditë e zakonshme qitjeje luftarake me granata dore. Qitje të tilla ishin normale dy herë në muaj dhe bënin pjesë në përgatitjen e rregullt luftarake të ushtarëve e kuadrove të regjimentit. Shefi i Armatimit të Regjimentit, oficeri Ndue Logu, drejtonte qitjen në poligon. Kishin filluar që në mëngjes, kur dielli sapo ishte ngritur mbi kreshtën e Malit të Dajtit dhe ngrohte me rrezet e tij atë luginë të ngushtë, të rrethuar me kodra të buta të pyllëzuara kryesisht me shqipë. Përmes kodrave, buzë një përroi të vogël, gjarpëronin transhetë luftarake, që i bënin të padukshëm ushtarët gjatë lëvizjeve në orët e stërvitjes.

FAMILJET FISNIKE SHQIPTARE NË KOPRIN E VENEZISË 11

Të shtunën me 26.09.2015 në Kopër të Sllovenisë mbajt me sukses simpoziumi për nder të familjeve fisnike Shqiptare në Koprin e Venedikut. Në këtë ngjarje shumë të rëndësishme që u organizua nga Shoqata kulturore shqiptare...

PO AFERON 100 VJETORI I SHKOLLËS SË PARË SHQIPE NË DUKAGJIN



Nga **LUIGJ SHYTI**

Malësia dhe banorët e saj, midis të cilëve pa tjetër edhe komuniteti dukagjinas, në jo pak raste janë konsideruar të pa shkolluar, nuk dinë të qeverisen, etj.

Kalemshinjë, që kanë shkuar një apo disa herë në këto zona, trumbetojë me të madhe se i njohin mirë këto zona dhe banorët e tyre. Por harrojnë, ndoshta me dashje, se asnjë vend nuk mund të njihet me një herë as me dy as me më shumë vizita të parapërgatitura, të paralajmëruara, etj. Një vend njihet shumë më mirë nga ata që kanë lindur dhe banojnë aty për një jetë të tërë, mjafton që të kenë dëshirë që të njohin, vlerësojnë dhe pranojnë vendin e tyre. Shkruhet mire kur kalemli të mos jenë gjithmonë në dorën e të tjerëve.

Shkruhej ashpër në një të përditshme, që në fillim të viteve '90. Shkohet deri aty sa kërkohet të analizohen ata që mundësonin ardhjen e këtyre malësorëve në qytet.

Po ndodhë që edhe nga komuniteti ynë po i dëgjojnë dhe shikojnë këto tam-tame, po i pranojnë deri në atë masë sa nuk e identifikojnë veten me prejardhjen e vet.

Ne duhet, që me fakte, me studime serioze të kujdesshme, qetësisht, në mënyrë të vendosur dhe urtësisht, të tregojmë se nuk kemi qenë dhe nuk jemi fare të pashkolluar, nuk jemi të prapambetur, por jemi të vonuar sepse të tilla ishin kushtet ekonomike shoqërore të kohës dhe vendit, natyrisht që nuk jemi pa të meta, madje jo të vogla.

Është koha, madje edhe shumë më parë, që të ulim pak flamurin e jehonës së pushkës, luftës, dhe të merremi më shumë me librin dhe lapsin, me arsimin dhe kulturën, me dijen dhe shkencën, pasi janë të domosdoshme për tu njohur, dhe për ti treguar asaj pakice, e cila bën shumë zhurmë dhe nganjëherë edhe vepron me rrëmbim, se nuk kemi qenë dhe nuk jemi aq të paditur sa duan të na paraqesin, duke gërmuar a më shumë dhe duke shikuar gjithçka me lupë për të gjetur të meta dhe pastaj për ti tun-

dur si flamur, siç ka ndodhur por edhe po ndodh.

Pikërisht për të ndihmuar në sqarimin e këtyre mendimeve jo dashamirëse, është e udhës të merremi me evidentimin dhe publikimin e zhvillimit të arsimit dhe kulturës në Dukagjin. Kjo është e domosdoshme, që të merremi me përparësi, si shoqatë, gjatë dy viteve në vazhdim, pa lënë mbas dore edhe veprimtaritë e tjera.

Në vitin 2017 mbushen 100 vjet nga hapja e shkollës së parë shqipe në Dukagjin, fillimisht në Theth nga prifti patriot Shtjefën Gjeçovi dhe me transferimin e tij në Prekal, po atë vit hap shkollën edhe atje. Pavarësisht jetëgjatësisë së tyre, gjithsesi është fillim, është hapje, prandaj, mendoj se duhet punuar në këtë drejtim. Por hapja e shkollave vazhdoj edhe në vitet e mëvonshme.

Një mundësi e mirë është gazeta "Dukagjini" që të pasqyrojnë në faqet e saj

aktuara dhe studiara. Burim shumë i rëndësishëm në këtë drejtim janë kujtimet e mësuesëve dhe ish mësuesëve që kanë punuar dhe drejtuar në periudha të ndryshme në Dukagjin, evidencat statistikore, etj.

Puna kulturore ka qenë pjesë e pandarë e punës në shkolla. Shkollat ishin dhe janë qendra të jetës kulturore kudo qofshin ato, prandaj krahas studimit mbi zhvillimin e arsimit del nevojë e domosdoshme edhe studimi i kulturës e zhvillimi i saj. Në këtë veprimtari, dhe mëndo se nuk është vetëm e nevojshme por e domosdoshme, është mirë që të afrohen, tu kërkohet bashkëpunimi me sa më shumë mësues dhe punonjës kulture, por edhe me drejtues dhe ish drejtues të pushtetit vendor. Bashkëpunimi me ish mësues dhe punonjës kulture që kanë ardhur nga zona të tjera jashtë Dukagjinit kanë dhënë ndihmesën e tyre në Dukagjin do të ishte një veprimtari me shumë vlera

tit të edukimit, do të humbasë një pjesë shumë e rëndësishme e historisë dhe e kulturës tonë.

Një qind vjet arsim në Dukagjin, në këtë zonë që konsiderohej, por edhe konsiderohet shumë e vonuar, nuk është pak. Janë shumë breza të morën njohuri nëpër këto shkolla.

Ne, brezi i sotëm, aktiv ose jo në punë, punonjës apo ish punonjës në arsim, e kemi për detyrë që të vlerësojmë brezat që punuan, madje në kushte shumë të vështira, të gjithëfarshme, edukuan breza të tërë, na edukuan edhe ne, dhe na dhanë drejtimin për edukimin e brezit të ri dhe për të përgatitur brezat e së ardhmes. Ne e kemi detyrë morale që të njohim dhe vlerësojmë shumë vështirësitë e të gjithë atyre djemëve dhe vajzave, atyre që ishin familjarë apo që krijuan familjen në Dukagjin të cilët nuk u tërhoqën por, me guxim, vendosmëri e dashuri pa marrë parasysh vështirësitë me të cilat u përballën, punuan me ndërgjegje, sollën arsim dhe kulturë shumë të mirë, por edhe njohën, zbuluan e morën kulturë për vete, të cilën e vlerësuan dhe e propaganduan kudo shkuan si një vlerë të shtuar në jetën e tyre. Është në nderin e punës tonë të mos harrojmë këtë punë të madhe të të gjithë atyre që u përballën me atë vonesë shekullore në zhvillimin e përparimin e këtyre anëve. Duhet të kujtojmë vështirësitë e rrugëtimeve përmes borës dhe stuhisë, lartësive të mëdha si Qafa e Tërthores, Shtegu i Dhëneve, Qafa e Boshit, e Bashkasit, e Shtogut, Mali i Shoshit, duke rrugëtuar për në punë, për shkollim të mëtejshëm, për në seminare kualifikuese, shkëmbim përvojë, etj. Kjo punë është e madhe dhe duhet vlerësuar. Por ka edhe një anë tjetër, sepse kur brezi i sotëm vlerëson brezat e kaluar, do të vlerësohet nga brezat që vinë.

Nga Dukagjini dhe shkollat e tij kanë dalë shumë e shumë nxënës të shkëlqyer, por edhe kanë qenë dhe studentë të shkëlqyer, mësues e edukator në të gjitha nivelet e arsimit në Shqipëri, njerëz të ditur në shumë fusha të jetës, që kanë shkëlqyer edhe në sudimet jashtë shtetit, të cilët meritojnë vëmëndje dhe vlerësim.

Dukagjini dhe Shoqata Atdhetare "Dukagjini" i kanë të gjitha kapacitetet intelektuale, mundësitë organizative dhe bashkëpunues, disiplinën në punë, aftësinë metodike, për të realizuar këto studime dhe për tua lënë brezave që vinë si një përvojë që ka shumë vlera, por edhe si një pjesë shumë e rëndësishme e historisë së kësaj krahine me shumë vlera.

E gjithë kjo punë, pa tjetër, që ka një kosto natyrisht modeste në krahasim me të tjera të mëparshme, por kam besim në realizimin e kësaj detyre shoqërore, historike dhe kulturore.



kujtime, dokumente, foto, intervista, etj në lidhje me shkollat dhe kulturën në Dukagjin. Hulumentimi për për gjetjen e dokumenteve, kujtimeve, fotove, është një punë me shumë rëndësi. Ngritja e grupeve të punës mbi bazën dhe parashikimi i planit të masave për organizimin e një konference shkencore për zhvillimin e arsimit dhe kulturës në Dukagjin, duke përcaktuar detyra konkrete. Në konferencë mund të paraqiten studime mbi shtrirjen e arsimit dhe kulturës, por dhe shkollimin në shkallë të ndryshme të popullsisë, si brenda Dukagjinit edhe jashtë ti. Madje, po të jenë e munduar të paraqiten edhe të dhëna nga studimet jashtë shtetit, shkëlqimin e studentëve dhe studiuesve kudo qofshin ata.

Krahas punës studimore të vlerësohen ata që filluan punën për arsimimin e malësorëve dukagjinas duke vendosur pllaka përkujtimore në vendet e para-

edhe për vetë studimin por edhe duke respektuar dhe kujtuar ata që punuan, dhe punuan shumë mirë në Dukagjin.

Është e rëndësishme që mbi bazën e studimeve dhe materialeve të mbledhura të mund të realizohet ndonjë botim që do tu duhej brezave të ardhshëm dhe vetë historisë.

Është jo e lehtë, por, është e mundur kryerja e këti studimi, i cili ka mjaftë vlera për sot, por edhe për të ardhmen. Për arsimin dhe kulturën në Dukagjin kanë punuar shumë e shumë djem e vajza, burra e gra nga Dukagjini, por edhe nga zona të tjera, qofshin fushore, apo malore, nga qytete të ndryshme të Shqipërisë. Kanë dhënë ndihmesën e tyre edhe shumë e shumë të tjerë jashtë sferës së arsimit, por në shërbim të arsimit. Këto nuk duhet harruar, sepse po të harrojmë këta veprimtarë, dhe këto veprimtari, këtë punë, këta aktor të fron-

PROFESOR MHILL (MICHAEL) MARKU

Dukagjinasi i pare i shekullit te kaluar i laureuar për histori dhe arte në SHBA



Nga Prelë Milani

Gojarisht në mënyre te pa të konfirmuar me ndonjë dokument, ka kohë që kam dëgjuar disa emigrant shqiptare te flasin me konsiderata te larta për një intelektual te shquar i lindur në Dukagjini në përfundim të Luftës së Pare Botërore, i arsimuar në Itali, emigruar prej andej në SHBA, ku ka fituar edhe titullin e Profesorit dhe duke lenë shume në fushën e letrave. Duke qenë, se personi në fjalë ka vdekur në mesin e viteve gjashtëdhjetë, kur nuk kishte as një komunikim mes vendlindjen dhe brezat e sotëm kishin dëgjuar shumë përciptas gojëdhëna, që tregoheshin dhe që ishin kontradiktore, qofte për emrin, qofte për profesionin e këtij shqiptaro-amerikani të shquar por i pa njohur në vendlindjen e vet.

Duke ditur se ka një Gazete "Dukagjini" dhe një Shoqate me te njëjtin emër dhe ka vite të tera që punon me përkushtim për evidentimin dhe studimin vlerave dukagjinase dhe mbartësve të tyre në dobi të atdheut, miku, kolegu, dhe gazetari i TV "Zërit të Amerikës", Pëllumb Sula më vuri në dispozicion një postim elektronik të zotit Gjeke Gjolekaj, që mban datën 2 tetor 2015, i cili hedhe pakëz drite mbi emrin dhe jetën e këtij Profesori, i cili ka te gjitha gjasat që të jete edhe dukagjinasi i pare që ka shkelën në token e SHBA-ve

Duke falënderuar postuesin Gjeke Gjolekaj dhe gazetarin e Zërit të Amerikës Pëllumb Sula, për interesin që ta bëjnë të njohur këtë personalitet në token që lindi, më poshtë botojmë postimin origjinal.

PROFESOR MHILL (MICHAEL) MARKU (1919-1966)

Kur dita më ditë pritej dalja në dritë e një libri të Prof. Michael Markut, ai vdiq papritmas në Monterey, California, ku ishte drejtor i shkollës shqipe n' Institutin e Gjuhëve të Ushtrisë

Amerikane. Vdekja e shpejtë e tij la në pikëllim jo vetëm familjen, farefisën e miqtë e shumët, por edhe ata që të ndierin e njëfshin nga shkrimet e tija aq të bukura.

Michaeli, megjithëse larg vendlindjes ishte në kulmin e duhun në shërbim t' atdheut dhe të shqiptarve, tue nderue malet bujare te Shalës që i dhanë jetë, Dukagjinin fole

rue, tue grabitë e masakruë populin. Po me ket kohë vritet burrisht tue luftue edhe baba i Michaelit me dy vllazën, tue e lanë atë foshnje dy muajsh. Me kujdesin e famullitarit, Michaeli në moshën e bukur fort të rritëshme hyni në shkollë në konviktin "Malet tona" në Shkodër, ku kreu filloren e gjimnazin shtetnuer, tue u shque gjithmonë i pari i klasës, i



Shqiptarizmi dhe mbarë shqiptarët, sepse nder shtyllat e shtypit të lira në mërgim, artikujt e tij ishin të pandërpremtë, plot shije letrare, me baza shkencore, konstruktiv, larg partinash, thjeshte dhe vetëm shqiptar në dobi të Kombit, pse i thjeshte dhe vetëm shqiptar ishte vetë Michaeli. Po kështu, shkruante ndër gazeta e revista të huaja sidomos ne anglisht tue synue me ndriçue e sqarue të huajët mbi Shqipni e të drejta të Shqiptarve.

Mhill (Michael) Marku leu në Shalë (Lotaj) në luftën e parë botnore, kur Serbët në ikje e sipër prej ushtrive Austro-hungareze shkelën dhunisht nëpër malet tona, ute djegë e shktar-

pari në sport, i pari në guxim, i pari në nderë e karakter, shembull në sjellje, fisnik në punë e në veprime, burr i matun nder gjykime, gja që provon mos përkulja e tij para të rijve komuniste te asaj kohe, që dhanë e mueren me e bindë të hynte në celulat e tyne, por jo vetëm që nuk me e mashtrua, por u qëndroi burrisht me arsye e grusht, tue u mundue me i ndricue se ishin në rrugë të gabueme, mbasi për Mhill (Michaelin) komunizmi ishte qysh atëherë pansllavizëm rreziku i kombit shqiptar, gja që tashma e pamë të gjithë. As demagogjia fashiste nuk e futi Mhill (Michaelin) Markun në kurthe. Burgimi i tij në Li-

ceun shtetnuer në Shkodër me 1940 provon qartë se ndjenjat e të ndyerit ishin me popullin e synimet e përpjekjet për një independencë të plotë, liri e demokraci të vërtetë për çka Shqipnia kishte aq nevojë.

Studimet universitare i kreu në Evropë, kurse në Kaliforni muer diplomën—Master Degree në arte e histori.

Në fund e ndjejmë për detyrë të theksojmë se veprimtaria kulturore kombëtare e shumëllojshme e Profesor Michael Markut, ishte shembull për të gjithë shqiptarët e mërgimit. Me vdekjen e tij mërgimi shqiptar humbë një shtyllë të fortë, një personalitet të dalluem në dobi të përgjithshme kombëtare. Qoftë i përjetshëm kujtimi i Tij.

JA SI KONFIRMON REDAKSIA E GAZETËS DIELLI

Profesor Marku lindi në Shalë të Dukagjinit me 27 Shtator 1919, i bir i Mark Markut dhe i Drande Mirashit. Shkollën fillore e bëri në Shkodër 1926-31 dhe pastaj studioi në Liceun Shtetëror të këtij qyteti prej 1931-1938 dhe vjetin e fundit e bëri në Tiranë me 1939. Me 1939-43 studioi në Farnesina të Romës, Itali, dhe u diploma rishtazi me 1964 në San Jose State College, Californi, me titull MA in History

Profesor Marku mësoi për pesë vjet në shkolla Italiane (1946-1950) dhe pastaj emigroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Qe profesor dhe pastaj Chairman në DLI të Monterey, Calif. Përveç artikujve të shumtë shqip dhe anglisht.

PROFESOR MARKU ËSHTË AUTOR I "THE RED PIONEER"

SHENIM: Javën e kaluar dërguam për ribotim shkrimin anglisht për Dedë Gjo'Lulin të Michael Markut, i cili shihet qartë se e kishte amerikanzuar emrin e tij të vërtetë shqiptar. Për t'ia adaptuar emrin e tij natyrës shqiptare menduam se emri Mikel ishte shumë afër emrit Michael, por një ditë më vonë gjetëm se emri i tij i vërtetë kishte qenë Mhill Marku e jo Mikel Marku. Kërkojmë falje për këtë. Të gjitha shkrimet e tij në gazetën "Dielli" janë botuar me emrin Michael Marku. Përzierja e emrave të huaj me emra shqiptar shumë herë shkakton huti. Disa lexues kërkuan të dinë më shumë për jetën dhe veprimtarinë e këtij shqiptaro-amerikani dhe për t'ua plotësuar dëshirën gjetëm këto shënime që ishin botuar në gazetën "Dielli" në qershor të vitit 1966, menjëherë pas vdekjes së tij.

Postoi Gjeke GJOLEKAJ,
me 2 tetor 2015

MEHMET SHPENDI, ORGANIZATORI I “DJELMNISË SË SHALËS”, I PARI FORMACIONI I ORGANIZUAR I RINISË SHQIPTARE

Shekuj më parë, kur princit Gjin Tanushi ju dha titulli “Dukë”, Principata e Arbrit mori emrin Dukagjin, e cila në shekullin e XV e udhëhequr nga Lek Dukagjini u bë shumë e fuqishme, e dyta pas Kasriotëve.

Pas vdekjes së Gjergj Kastriotit, Leka, siç shkruan Prelë Milani, e vajtoi si burri burrin dhe u betua për qëndresë. Nga viti 1468 deri në vitin 1479, përfshirë këtu edhe rrethimin e katërt të Krujës (1477), popullin shqiptarë në luftë kundër Turqve e udhëhoqi Lek Dukagjini, duke qenë, kështu, udhëheqës i shquar dhe ideolog. Nga Dukagjini kanë dalë burra të zgjuar dhe trima gatë gjithë historisë. Ndër këto është edhe Mehmet Shpendi, i cili u lindi, u rrit dhe u burrërua në malet e lartë të Dukagjinit, ku njerëzit përballeshin me sakrificë jetën, sepse natyra nuk ishte aq bujare, por ata i përballeshin me sakrificë për të qenë të lirë, duke sfiduar mëkatet e natyrës ata jetuan me nder dhe dinjitet dhe siç thotë rapsodi popullor “atje mbretën janë te tanë”.

Përveç kësaj, atje mbizotëronte analfabetizmi, asgjë nuk e pengoi që Mehmet Shpendi në vitin 1895, ideoi dhe krijoi Shoqatën “Djelmnia e Shalës”, e cila u shtri në të gjitha zonat e Dukagjinit dhe që u bë tmerr për armiqtë, turqit Osmanli, sllavët Serbo-Malazez, e të tjerë. Në vitin 1910 në Qafën e Agrit, bashkë me Prelë Tulin me trimat e Nikaj-Merturit, thyen keqas pashallarët e Sulltanit. Në këtë luftë ata shfrytëzuan mbetjet e një topi, që mjeshtri popullor, patrioti Mitër Kola e beri te tmerroje armiqtë, betejë kjo që hyri në histori dhe për këtë patrioti Dedë Gjo’Luli e quante Mehmet Shpendin “Gjeneral”. Gjithashtu edhe në luftën që u

bë në Luginën e Shalës u mposhtën forcat ushtarake Serbo-Malazeze. Me Djelmninë e Dukagjinit, Mehmet Shpendi, shkoi te Dedë Gj’Luli, në Deçiq në vitin 1911 dhe morën pjesë në ngritjen e Flamurit Shqiptar. Këto momente janë pasqyruar edhe nga Risto Siliqi, ku midis të tjerave shkruante:

“...Me qetësi e la jetesën,
Sall martinën e ka rrokë,
Burrash në burri e muar pjesën,
Me djem t’ri komita shokë...”

Përveç luftërave ku mori pjesë, “Djelmnia e Shalës” rinovoi shumë nga rregullat e vjetra të jetës shoqërore, si për fejesat, dasmat, kumbarinë, vdekjet, kundër vëllavrasjes, rregulla këto që u mirëpritën nga paria e krahinave në atë kohë. Duhet të kemi parasysh rrethanat në të cilat u krijua Djelmnia, e cila bëri bashkimin e rinisë, kur në Shqipëri nuk ekzistonte asnjë formë bashkimi dhe u deshtë një gjysmë shekulli më vonë (1941) që Qemal Stafa krijoi “Bashkimin e Rinisë Antifashiste Shqiptare”. Sigurisht si të dalë në dritë e vërteta objektive, pra historia, duket që subjekti ta nxjerrë në dritë dhe kjo edhe për Mehmet Shpendin. Meritë për nxjerrjen në dritë të këtij vigani trim i përket Shoqatës Atdhetare “Dukagjini” dhe veçanërisht kryetarit të shoqatës, Ndue Sanaj, ushtarak karriere me gradë të lartë dhe kurdoherë i suksesshëm. Ai, me stilin dhe metodën e tij prej ushtaraku i kaloi hezitimet dhe organizoi Shoqatën Atdhetare



“Dukagjini”, si e vetmja në Shqipërinë e Veriut, që ka një bashkëpunim me një shtrirje gjeografike nga Peja e Rrafshi i Dukagjinit deri në Tiranë dhe që andej edhe përtej oqeanit, në SHBA. Ai punoi pa u lodhur për të zbuluar dhe lartësuar vlerat, për të zbuluar dhe lartësuar vlerat atdhetare e shoqërore dhe për të nxjerr në pah figurat që kanë bërë histori, siç qe rasti në 90 vjetorin e vrasjes së Mehmet Shpendit, i cili u dekorua me Medaljen e Arte të Shqiponjës, pastaj në 100 vjeto-

rin e vrasjes që ju dha titulli më i lartë “Nderi i Kombit”. Me këtë rast u ngrit edhe monumenti dhe u vendos në një nga rrugët kryesore që lidhen me krahinën e Dukagjinit. Ai ka mbajtur gazetën “Dukagjini” ne faqet e të cilës janë pasqyruar ngjarjet historike, luftërat e Dukagjinit kundër regjimit antipopullor të mbretit Zog, ka evidentuar shumë figura të mbetura në heshtje nga mëkatarët e historisë dhe çdo ditë e më shumë jehona e Shoqatës po ndihet kudo dhe për këtë meritë e respekt ka kryetari i shoqatës Ndue Sanaj. Sigurisht, Ndue Sanaj nuk është vetëm. Ai, është me bashkëpunëtor e bashkëpunëtore të palodhur, siç është N/Kryetari i shoqatës, Gjergj Leqezja; Sekretari i Shoqatës, Luigj Shyti; anëtarët e kryesisë: Mhill Prroni, Roza Pjetri, Prele Milani, Dukate Bregu, Marie Ferosi, Lazer Kodra e Marinela Buxha, dhe bashkëpunëtoret e tjerë të palodhur, siç është Kryetari i Këshillit të Shoqatës, Prele Shytani, anëtarët e këtij këshilli Aleks Dushi, Kole Çardaku, Ndue Mici e të tjerë, të cilët janë si një trup i vetëm në vendimmarrje e në realizimin e çdo nisme që marrin për sipër. Ju lumtë dhe ju përgëzoj për punën që po bën Shoqata Atdhetare “Dukagjini”, në interesin e bashkësisë dukagjinase, asaj shkodrane e për mbare hapësirat Shqiptare!

Pjetër Delia,
dhjetor 2015

NJË 80 VJETOR I BUKUR

Tani janë bërë mode, që në festime për vjetorin të mblidhen familjarët të afërm e shoqëria. Secili e feston sipas mundësive dhe metodave të organizimit. Kryesore është të mblidhen e të bisedojnë, të çmallen me njëri tjetrin. Duke kujtuar vitet e kaluara e ku në memore kalojnë si një film me metrazh të gjatë. E cila fillon me fëmijërinë, adoleshencën, rininë e cila është më e bukura në jetën e secilit. Vitet rrjedhin me gëzime e hidhërime me suksese e deshtime. Po lumi ai ose ajo qe mosha e tretë i vjen mbare. Mbarë i ka ardhur edhe ati të cilit po i festojmë 80 vjetorin. Fjala është për Ndue Gjin Lojzin i cili lindi në dhjetor të vitit 1935. Në një familje të madhe e të njohur në malësi e në qytet. Familje punëtore, patriotike e bujare, pra me tradita të shkruara në histori. Kjo datëlindje na mblodhi sot në një nder lokalet më luksoze në Shkodër. Me një menu shumë të pasur dhe të servirur me kulture, siç dinë të servirin Shkodranët.

Ndoja është fëmija i dytë i të ndjerve Gjin e Drande Lojzi, nga tetë që kishin, 2 djem e gjashtë vajza. Ku 7 prej prej tyre jeto-

jnë, punojnë dhe kane kushte të mira jetese. Me djem, vajza, nipër, mbesa, madje edhe me sterniper. Shperndarja e tyre është në të gjithë botën. Rëndësi ka se kudo që jetojnë e punojnë, janë të nderuar e me fjalë shumë të mira. Pra kanë trashiguar traditat dhe vertytet e larta të familjeve prej nga rrjedhin. Duke qenë familje e madhe dhe e nderuar ka lidhë mëqesi me po familje të medha e të nderuara, ku do të veçoja miqësinë me Lulash Gjelošin e Shoshiit, Gjeloš Kolën e Abatit, Gjergj Micanin në Theth, Mirash Binoshi në Lotaj, Vogël Pjetren në Dakaj, Ndoc Kelin e tjerë. Ndoja u martue me Zojë Gjergjen nga Thethi para 60 vjetesh. Një çift ideal qe edhe sot thonë e keni teper me pas bukurin e Ndue e Zojë Lojzit. Ky çift bashkshortësh punuan, Ndoja ushtarak dhe Zoja në tregëti, derisa dolën në pension. Puna e tyre është vlersuar vazhdimisht. Janë nderuar disa here me stimuj moral, siç i diktonte koha. Këta linden e rritën 3 fëmijë, një djal e dy vajza. Fëmijët janë rritur, kanë mbarue të tre shkollat e larta. Janë martuar me intelektual, mjek, inxhiner, mesues. Edhe fëmijët e tyre kanë mbaruar shkollat e larta në specialitetet të ndryshme. Punojnë jetojnë shumë mire. Paulini familjarisht jetojnë në Kanada. Falë arsimimit e specializimeve të perfunduara në Kanada. Tani me plotë bindje mund të themi

se janë integruar tërësisht në jetën e kulturën Kanadeze. Punojnë dhe jetojnë shumë mire, madje kanë arritur që të kenë një biznes të fuqishëm në Toronto. Edhe vajzat Vitoria e Gita, respektivisht punojnë në Prokorori të rrethit gjyqësor Shkoder dhe Gita ne arsim. Të dyja kanë biznese, janë të nderuara e të respektuara në familje e shoqëri. Mbi të gjitha është per tu admiruar respekti që kanë per prindit dhe të afermit e tyre. Këtë e verteton ma së miri ardhja e Paulinit bashkë me nusen Vera nga Kanadaja e largët, per të festuar 80 vjetorin e babes Ndoje.

Ishte shprehje e dashurisë e respektit për prindrit. Vlen per të veçuar se ky 80 vjetor e gjenë Ndue Lojzin stergjysh, pasi djali i madh i Paulinit, Gjergji para sa kohësh u ba me djale. Urimet, muzika, fotografit nuk kanë të mbaruar. Terhoqi vemendjen e të gjithëve një video e bërë para 20 vitesh. Në 60 vjetorin e lindjes të Ndojës. E cila ishte ruajtur me shumë kujdes nga Paulini. Për një moment ra heshtja, se disa që u shfaqën në video ishin ndarë nga jeta. Por ky është ligji i natyrës.

Në mes të shumë urimeve nga të pranishmit do të veçoja urimin që i bëri Ndojës intelektual i njohur Ndoc Grima; Të bëhesh mbi 100 vjeç, dhe gjithmonë i qeshur i gëzuar e simpatik, ashtu siç të njohim prej shumë vitesh. Por një urim të mire, me sa

duket ja beri edhe natyra. E cila me sa duket qeshte e gëzohej. Ishte një ditë pranvere në dhjetor. Kur e pyet Ndojën se cila është receta që ke ndjekur në jetë, se mbushë 80 vjet e nuk jep as për 60. Pergjigjia është e ëmbelë e butë, ashtu siç ka ditur me fol gjithmonë Ndoja. Faktorët janë të shumët, por theksin do ta vëja tek disa prej tyre; Njëri prej ketyre arsyeve është harmonia, dashuria dhe repeti bashkshortor që kemi patur ne per njëri tjetrin për rreth 60 viteve të martuar. Në saje të kësaj dashurie ne kemi arritur që të përballojmë veshtirësit e jetës. Por kryesorja ka qenë rritja e edukimi i fëmijëve deri sa kanë dalë në jetë. Pra i jam mirënjohës gjithë jetën Zojës. Por edhe fëmijëve të mbrekullueshem që kemi. Të cilët na duan e na respektojnë, kujdesen në çdo moment per ne. Kjo më bënë krenar për fëmijet, nipat e mbesat dhe bashkeshortet e tyre. Po edhe vëllaj Leka dhe motrat të cilat kurdoherë më kanë sjell gëzime e dashuri. Gjithë gjaku i afermet i imi, i cili i kalonë të 100 vetat. Ne u shperndam me ndjenën dhe deshirën, për tu takuar kesh-tu, siç jemi sot edhe në 100 vjetorin e lindjes te z. Ndue. Ky ishte edhe urimi i të gjithë të pranishëve në këtë eveniment të gezuashëm familjarë.

Nga Ndue Ziçi

LAMTUMRË NDUE CUKELI

Atë që nuk e bëmë ne, të gjallët jam i bindur se sonte do ta bëjnë gjyshërit dhe etërit tanë!

Të nderuar familjare, miq, shoqe, koleg, dashamire të njohur, autoritete publike dhe fetare! Jemi mbledhur pa dëshirë në këtu vend të bekuar në prag ndërrimit të moteve, Jemi mbledhur këtu sot pasi vullneti i krijuesit tonë të gjithë pushtetshëm thirri pranë vetes, njeriun e mire, patriotin e dëlirë, intelektualin kurajoz, ushtarakun e talentuar veprimtarin shoqëror të pa lodhur, njeriun e pasionuar të letrave, dashnorin e përkushtuar të Dukagjinit, familjarin dhe shembullorin Ndue Cukeli.

86 vjeçar Ndue Cukeli, filloi pushimin e pasosur, duke lenë pas emrin të skalitur si bire i shquar i Dukagjinit:

Ndue Cukeli është pinjoll i një dëre të vjetër të Shalës, të sprovuar në sfida atdhetarizmi, bujare dhe burrim shembullor. Cukel Delia zinte kreun vendit në radhën e plis-bardhëve kryengritës kundër Shefqet Turgut Pashës me 1910, 1911 dhe kundër Kral Nikolles me 1915. Në rrathët jetës tende me dritë, diell, freski, murllan e stuhi kanë lenë gjurmë, gjurmë e tyre të pa shlyera, mjerimi Migjenian i kohës Zogolljane, aspirata liridashëse antifashiste, së cilës ju përkushtove që në moshë të re, duke u bere pjese e saj dëshira për progres e drejtësi dhe zhgënjimi në diktaturë! Ndue Cukeli me djerse, sakrificë e përkushtim u arsimua, u formua si specialist i devotshëm. Një ushtarak i talentuar karriere që ka kryer me nder dhe de-

vocion funksione të ndryshme në ushtri deri në detyrën e Zv/Komisare i Brigadës së Këmbësorisë dhe Komisari Regjimit



Rezervist të Veriut. Kuadër me shume vullnet në pune, i dashur në shoqëri, i vendosur për të punuar me shoqe dhe për të çuar deri në fund detyrat. Sot u nda nga ne, një në burrë, nga më të hijshmit e florës sonë alpine. Sot në rripet e maleve qiell prekëse të Shalës u shua një bredh, të cilin dergja e shytoj bri më bri, por nuk rrezohet dot me një trame. Ndue Cukeli luftoi pa u trembur me sëmundjen vrastare për vitet të tera,

duke treguar vitalitet dhe forcë karakteri të pa epur. Njerëzit e forte dhe të mire si ju, Zoti i ka krijuar si shëmbëllim sfidues kalimtare nga jeta përditshme në jetën e pasosur.

Sot u nda nga jeta një mik i gazetës dhe Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", një hulumtues i pasionuar historisë dhe i kulturës popullore të kësaj zone, që e deshi si djali atin. Ndue Cukelin, tani po e përcjellim në boten tjetër, por dashurinë dhe shpirtin e tij e la këtu mes nesh, në botimet disa vëllimshme për njerëzit kulturën dhe traditat e Dukagjinit e tij. (Dukagjini nder shekuj", "Ndhmo Zot ora e Shalës", Mark Lula Prijësi i Dukagjinit" dhe "Përmbi mal shkëmb e gur fiset Nikaj Mertur") Libri "Dukagjini nder shekuj", është dhurata më e vyer që mund të bëjë një studiues për vendlindjen e tij. Ai ishte libri jetës dhe ndonëse ka 23 vite në qarkullim është e do mbetet "Abetarja historike e pare e Dukagjinit", një udhë-rrëfyese për gjithë ne studiuesit e kësaj zone emblem-atike.

U nda nga ne, një burrë i pashëm, i heshtur, i thjeshtë, i imponant që nuk dite se çfarë janë autolevdatat.

Largimi juaj nuk ishte papritur, pasi 86 dimrat bënë dimrin e tyre final, por ju e jetuat jetën duke qenë model tregues se, si duhet të jetojmë e vdesim me dinjitet. Sot, armata krijuese dukagjinase ndihet e pikëlluar thellë se humbi babaxhanin e odes krijues. Deri dje, të kishim këtu, në mes nesh, por qofte nga rutina e përdit-

shme, qofte nga vesi jo i mire për të mos vlerësuar të gjallët nuk të thamë kurrë në kor faleminderit dhe të lumtë dora Ndue Cukeli për çfarë bere për Dukagjinit!

Atë, që nuk e bëmë ne, të gjallët jam i bindur se sonte do ta bëjnë gjyshërit dhe etërit tanë, të cilët do të presin krahë hapur. Sonte, do pres e të urojë mirëseardhjen gjyshi yt, Cukel Delia, me Mark Lulen e Mehmet Shpendin, Kolë Mark Kolen, Zekë Jakinin, Marash Tucin, Sokol Tonen, Pal Gjokën, 7 shaljanet, Babun Celin, Mark Milanin, Ndokë Gjeloshin, Vas Kirin, Gjelosh Ramën, Prel Tulin e Tomë Kolen. Sonte, do presin e të urojë mirëseardhjen e gjithë elita atdhetare, kulturore e Dukagjinit nga Zef Jubani deri tek Martin Camaj, për të cilët ti kontribuove që ti memorizosh në kujtesën e brezave.

Ti e meriton përjetësisht urimin e tyre: "Tu rritë ndera Ndue Cukeli!"

Të nderuar miq, Ndue Cukelin, që nga sot e pas nuk do ta shihni kurrë në mesin tuaj, por emri dhe kujtimi i tij do mbesin në mes nesh. Kush do që ta takojë Ndue Cukelin mund ta gjej përsëri mes radhëve të librave të tij dinjitoz, për të cilët nga ne, të gjallët deri më sot kurrë nuk mori vlerësimin e merituar, pavarësisht, se nga Shoqata "Atdhetare, Dukagjini" I është dhënë titulli "Mirënjohja e Shoqatës", për kontributin e tij studimore për zonën e Dukagjinit.

Të qofte dheu i lehtë!

Shpirti juaj u prehtë në paqe!

Përgatiti **Prele Milani**,

anëtar i kryesisë se Shoqatës "Atdhetare-Dukagjini"

PËR.. LEXUESIN..


KUSHTUAR VËLLIMIT ME POEZI, ME TITULL "SI MUNDEM ME IK PA TY", TË AUTORIT NDOC SELIMI

Vëllimi poetik "*Si mundem me ik pa ty*," i autorit Ndoc Selimi, vjen i treti libër në radhë, i publikuar gjatë viteve të fundit. Pas përmbledhjes me poezi "*Brirët e hënës*" dhe studimit historik "*Kultura e Komanit dhe Komanasit*", punës disavjeçare i shtohet edhe ky titull, duke arritur një sukses tjetër, një vlerë më shumë në krijimtarinë e tij.

Në vëllimin e parë me poezi, botuar më 2003 është konceptuar në dy gjuhë; shqip – italisht, duke na sjell varg pas vargu e strofë pas strofë botën e veçantë dhe zërin e emigrantit, pjesë e të cilit është edhe vetë autori. Në këto poezi ndjehet haptazi shkëputja e dhimbshme nga rrënjët, malli për atdheun e dhunuar nga viti i mbrapshtë, 97', vendimin për tu larguar e për të mos ecur në rrugën e urrejtjes e të vdekjes, të përshkruar nga Kaini, për të mos humbur orientimin dhe vetveten.

Libri i dytë, "Kultura e Komanit dhe Komanasit," botuar në vjeshtën e vitit 2013, është një studim sa historik aq edhe shkencor, një guxim "komàn" - siç mund ta quajmë, për t'i sjellë historisë shqiptare burime të reja e të panjohura deri tani, duke provuar të thyjë disa tabu nacionaliste.

Libri i tretë, i dyti vëllim me poezi, vjen



me ngjyra të reja. Autori, meqenëse vjen nga ashti i Gegërisë, vendos të na flasë pikërisht me këtë akcent. Pra, poezitë na vijnë me të plota, jo vetëm në tematikë, por edhe në figuracione e freski letrare, aq sa, ... disave iu rikthehesh për t'i lexuar me dyfishin e ëndjes.

Tematikat janë të larmishme dhe

dashuria e autorit për pjesëzat e jetës që kanë lenë gjurmë në rrugën e vet, u jep frymë dhe i ngjall, duke u shkrirë edhe vetë brenda saj. Mbi të gjitha, në këtë vëllim mbizotëron shqetësimi i autorit për bjerrjen, braktisjen që bashkëkombësit e vet po i bëjnë vendit të tyre, siç janë; largimet masive, boshatisja e fshatrave, qyteteve dhe deri te mërgimet për në dhera të huaja. Gjatë leximit të këtyre poezive duhet të kesh lapsin në dorë për të nënvizuar vargje brilante si; - Në vendin tim lulet kanë pamjen e diellit. (Asht koha e ardhjes). - M'sollën një lule, por mjerisht lulëzon në ballkonin e vendit t'huej - duke i bërë një aludim emigracionit dhe fëmijëve të tij, që po rriten dhe japin kontribut jashtë atdheut. - Gjysh! Kur të bjerë floku i borës parë, ndoshta kthehem, me t' dhurue pallton teme prej zofi...për një gjum' të gjatë e të qetë, në vetminë e pasosun. (Vorri i gjyshit).

Edhe pse nëpër poezitë e këtij vëllimi hyjnë si "rastësisht" tema të tjera, ku autori i bën me qëllim, për të mos rënë shpirtërisht në një farë pesimizmi, për të mos u vrarë nga kuptimet absurde të trishtimit të kohës së kaluar dhe të një pjese të asaj që po kalojmë sot, përsëri u kthehet trajtimeve që aq shumë u ngjajnë lindjeve të diellit, besimit te e ardhmja, me nuancat e ndjeshme të dinjitetit dhe krenarisë njerëzore e kombëtare. Të tilla vijnë poezitë; "Atdhe", "Idil vere në Ulqin", "Urimi i gjethes", "Rizgjimi" e të tjera.

Unë jam një njohës modest i gjuhës gegërishte, ashtu siç jam fjala vjen i

këngës labe me iso. Por kur shkruhet apo këndohet diçka bukur të jep emocione. Kështu ndodh edhe me poezitë e këtij vëllimi.

Por edhe vetë autori është i sinqertë se të shkruarit në këtë drejtskrim është një shkollë e kulturë në vete. Përpjekjet e tij në vëllimin e ri poetik "*Si mundem me ik pa ty*" tregojnë një arritje të suksesshme që duhet inkurajuar e përshëndetur për t'i dhënë rëndësinë dhe vlerën njërit prej kryedialekteve të gjuhës shqipe, i cili na vë në sofrën e parë për nga vjetërsia e kombeve. Pavarësisht se vetë Ndoci, prej gati një gjysmë shekulli jeton jashtë "magjes ku gatuhet kjo bukë", ku flitet gegërishtja, përsëri ka arritur t'i a dalë mbanë, për të risjellë ndër né, atë gjuhë të bukur që kanë kënduar poetë e shkrimtarë të pavdekshëm të veriut, që nga vitet e Rilindjes e deri sot, si; Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani, Shiroka, Vaso, Fishta, Mjeda, Koliqi, Migjeni, Camaj, Pipa, Repishti e të tjerë.

Në sajë të begraundit të tij, Ndoc Selimi ka njohje dhe korrespondencë me miq e letërshkrues në tërë kontinentet, por ai e ka ndjerë nevojën shpirtërore të "flasë" nëpërmes poezive të tij, me atë pjesë të miqve që ka lenë në vendin e vet, në sofrën e të "varfrës" Shqipëri, e cila i "dha mundësi" të fluturojë larg.

Dhe e bën mirë,
dhe e bën me dashuri,
dhe e bën me art.

Përgatite nga
SAMI GUZINA

PER AVIATORIN NDUUE LOGU

Pjesë nga libri "Shqiponja e Qiellit" kushtuar deshmorit te atdheut Ndue Logu



Shkruar nga GJIN MUSA

Ajo ishte një ditë si gjithë të tjerat. Një ditë e mezit të shtatorit, me një diell që me kalimin e orëve fillonte e ngrohete më shumë. Në poligonin e qitjes në Farkë të Tiranës ishte një ditë e zakonshme qitjeje luftarake me granata dore. Qitje të tilla ishin normale dy herë në muaj dhe bënë pjesë në përgatitjen e rregullt luftarake të ushtarëve e kuadrove të regjimentit. Shefi i Armatimit të Regjimentit, oficeri Ndue Logu, drejtonte qitjen në poligon. Kishin filluar që në mëngjes, kur dielli sapo ishte ngritur mbi kreshtën e Malit të Dajtit dhe ngrohete me rrezet e tij atë luginë të ngushtë, të rrethuar me kodra të buta të pyllëzuara kryesisht me shqipë. Përmes kodrave, buzë një përroi të vogël, gjarpëronin transhetë luftarake, që i bënë të padukshëm ushtarët gjatë lëvizjeve në orët e stërvitjes.

Ushtarët vinin njëri pas tjetrit në pozicionin nga ku do të hidhnin granatat e dorës në drejtim të objektivit të vendosur brenda një rrethi të bardhë. Synimi ishte për ta hedhur brenda atij rrethi, pasi kishte siguri më të plotë precizionin në asgjësimin e armikut. Granatat e vërteta luftarake shpërthenin me zhurmë e ushtarët uleshin në transhe për të mënjanuar rrezikun e goditjes nga ciflat vdekjeprurëse. Ndue Logu, i ndiqte ata me vëmendje, me përkujdesje, me seriozitet e rreptësi për zbatimin e rregullores dhe të kushteve të sigurimit në poligon. Ai kishte punuar për 25 vjet si pilot dhe si kuadër drejtues i regjimentit të helikopterëve në Farkë. Por, pas 25 vjetësh, gjatë një vizite mjekësore, mjeku i dha një lajm të papritur e të hidhur për të: Nuk duhej të fluturonte më. Nuk kishte asgjë për t'u shqetësuar në gjendjen e tij shëndetësore në përgjithësi, por pas kaq vitesh në ajër, disa parametra fizike nuk janë më në lartësinë që kërkon një misioni në tillë. E priti me hidhërim, por duhej të bindej. Kushtet e punës në aviacion e kërkonin edhe këtë. Kur doli jashtë në oborr, sytë vetvetiu i shkuan nga qielli, ku ai ishte mësuar të ngjitej sikur konkuronte me shqiponjat. E në mendje i erdhën fjalët e Leonardo Da Vinçit: "Njëherë ta keni pr-

ovuar fluturimin dhe do të ecni tërë jetën me sytë në qiell". Për të mos u ndarë nga regjimenti, kolegët e ushtarët, pranoi të mbulonte detyrën ushtarake që kryente tani.

Ora po shkonte 11. Bulëza djerse filonin të dukeshin në ballin e ushtarëve me uniformë, por edhe të komandantit të tyre. Dielli i shtatorit dhe uniforma e bënë punën e tyre. Ishte radha e një djaloshi 19-vjeçar, pak i ndrojtur nga natyra. Ishte i fundit që do të kryente qitjen. Ndueja i rrinte afër, instruksionet e këshillat e momentit, si për secilin. Shokët, të gjithë djem të rinj, 19 – 20 vjeçarë, ishin fare afër e ndiqnin me vëmendje shokun e tyre që do kryente qitjen. Ai, mori nga pozicioni i zjarrit granatën dhe ja hoqi sigurecën. Në fraksione sekonde duhej ta hidhte atë drejt objektivit armik. Por në momentin kur shtriu krahun për ta hedhur, një çast pasigurie, bëri që granata t'i shpëtonte nga dora e të binte në tokë. Në dorë i kishte

bej qoftë edhe një fraksion sekonde. Jeta e atyre djemve 20-vjeçarë ishte në rrezik. Ai, si komandant, por edhe si prind, nuk mund ta lejonte këtë. Në shtëpi, kur kishte dalë në mëngjes, kishte lënë në gjumë dy vajzat e tij, ende të vogla, të cilat e prisnin me aq dashuri kur kthehej në darkë. Ata djem kishin prindër që i prisnin të ktheheshin shëndoshë e mirë nga shërbimi ushtarak e drithëroheshin për ta. Komandanti, me shpejtësi të rrafshme kapi për krahu djaloshin e hutuar nga tmerr dhe e zhyti në transhe, duke e shmangur nga rreziku. Si një shqipe që hidhet pingul mbi gjarpërin, ai u hodh mbi granatën që ishte duke plasur. Me trupin e tij të lartë prej atleti zuri rrezen midis granatës dhe grupit të ushtarëve. Tentoi ta hidhte drejt objektivit, por granata plasi pa e marrë ende mirë rrugën. Një nga ciflat e mallkuara gjeti krahërorin e komandantit, duke çarë arterien kryesore të trupit të tij, aortën. Ai ra përdhe thujse pa ndjenja. Gjaku

e vdekjes, kur fare mirë mund t'i shmangej asaj? Vërtet, Ndue Logu, mjaftonte të zinte ushtarin për krahu e të hidhej bashkë me të brenda transhesë. E do të kishte arritur si për natë gjallë e shëndoshë tek bashkëshortja Vera dhe tek vajzat e tij Albana e Laureta. Po ata djem 20 – vjeçarë, me të cilët e lidhte jo vetëm detyra, por edhe miqësia e dashuria njerëzore prej vëllai apo prej prindi? Ata mbase do të kishin mbetur përjetë aty, shtatore të palëvizshme në poligonin e qitjes.

Një komandant e një njeri si Ndue Logu, nuk mund t'ja lejonte kurrësesi vetes një gjë të tillë. Për të ishte më e lehtë, më e natyrshme e më burrërore hedhja në krahët e vdekjes në emër të jetës së të tjerëve, sesa lënia e të tjerëve në thonjtë e vdekjes. E kjo mund të kuptohet fare mirë vetëm po të kemi parasysh zonën nga vinte ky djalosh me tipare shqiponje dhe traditat e trimërisë e të heroizmit të familjes së tij.

Ndue Logu u lind më 8 maj të vitit



mbetur vetëm sigureca. Djaloshi e humbi toruan dhe u zverdh në fytyrë. Momente paniku dramatik tek fytyrat e shokëve. Papritur vdekja ugruzezë ishte shfaqur mes tyre e mund t'ua merrte jetën nga një sekondë në tjetrin. Sytë e tmerruar të të gjithëve ishin drejtuar tek ai objekt në formën e një veze e pak më i madh se ajo, që mund të shpërthente në mijëra copa e t'i godiste për vdekje.

Por, komandanti Ndue nuk e humbi gjakftohësinë. Truri i tij punoi me shpejtësi marramendëse. Nuk mund të hum-

filloi të vërshonte mbi uniformë që nga krahërori. Ushtarët, që i kishin shpëtuar rrezikut, u mblodhën të tërë rreth trupit të Komandantit. Ai, si nëpër gjumë, i hapi sytë me mundim, u hodhi një vështrim, ravijëzoi një buzëqeshje dhe mezi foli: Gjallë jeni të gjithë? E sytë e tij u mbyllën pa prituri përgjigjen...

TRADITË BREZASH

Përpara një ngjarjeje të tillë, gjithësekush mund të bëjë natyrshëm pyetjen: Si është e mundur që njeriu të hidhet kaq lehtë, me vetëdije në krahët

1940 në fshatin Brashtë të zonës së Dukagjinit në malësitë e Shkodrës, pikërisht në prehër të Alpeve. Mjafton të përmendësh krahinën e fillon menjëherë të kuptosh shumë gjëra. Si autor i librit, duke qenë dukagjinasi, kam dëshirë të ndalem pak pikërisht mbi ato vlera të pakrahasueshme që mbart kjo zonë e që ua ka ushqyer bashkë me qumështin e nënës edhe bijve e bijave të tij në shekuj e deri në ditët tona. Ato zona me bukuri të egër por të mahnitshme kanë qenë në shekuj teatër betejash të përg-

jakshme për mbrojtjen e Atdheut dhe të tërësisë territoriale të tij. E në atë teatër ngjarësh tragjike, bijtë dukagjinasi kanë qenë përherë protagonistë. Poeti i mirënjohur Hysni Milloshi shkruan: "Kur sjellim në vëmendje kreshnikët e rapso-dive veriore, para syve na del Dukagjini i Shkodrës me rrethinat e tij. Në ato male me bukuri përrallore lindën Ajkunat, Mujot e Halilët. Bukuritë e jashtëzakonshme natyrore të atyre bjeshkëve madhështore ndikuan që në ato kulla të rriteshin burra me shtat e mendje madhështore. Në ato vise u krijua për herë të parë legjenda e Orëve e Zanave prej fantazisë popullore, gjë që me siguri ka ndodhur në kohërat para Homerike. Sepse vetëm në ato vise me njerëz shtatlartë e plot fuqi të mbinatyrshme mund të besohej një Orë, domethënë një grua shtatlartë me fuqi të mbinatyrshme dhe me hijeshi po aq të jashtëzakonshme. Sepse vetëm në vise si ato të Dukagjinit mund të besohej se rrojnë zanat, vajza të reja me bukuri të jashtëzakonshme e gati të mbinatyrshme si orët, që endeshin pranë krojeve, fushave e lëndinave plot lule, ku dhe shirat derdhen në formë ylberesh. Edhe sot e kësaj dite të krijohet përshtypja se malësorët shtatlartë e fisnikërlartë të Dukagjinit kanë lindur prej Nënës Orë për me mbrojtë vendin, traditat e shenjta, fisin, njeriun..."

Dukagjini. Emri i tij e ka prejardhjen pikërisht nga njëri prej bijve të tij të shquar. Të dhënat historike tregojnë se aty nga viti 1281, i pari i kësaj zone ishte Gjin Tanushi. Ai tregoi aftësi të veçanta ushtarake në shërbim të Bizantit dhe për meritat e tij u dha titulli "Dukë". Pra Duka Gjin. Me kalimin e kohës titulli me emrin

u shkrinë në një të vetëm dhe familja e tij filloi të njihej me emrin familja e Dukagjinëve, çka i dha emrin krahinës e Principatës së Dukagjinëve. Padyshim, personaliteti më i njohur e më i shquar i kësaj familjeje mbetet Lekë Dukagjini, i njohur si për trimëritë e tij në luftë kundër pushtuesve turq, përkrah Skënderbeut dhe pas vdekjes së heroit tonë kombëtar, ashtu edhe për kanunin, që për shekuj me radhë ka qenë kushtetuta e maleve.

Në vitet e zjarra të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, dukagjinasi ishin një forcë aktive në mbrojtje të tokave shqiptare. Përfaqësuesit e kësaj zone, Mark Lula e Gjekë Gega, ishin pjesëmarrës në Lidhjen e Prizrenit më 15 qershor të vitit 1878. Ndërsa mbi 200 luftëtarë dukagjinasi morën pjesë me armë në dorë në betejat kundër aneksimit të tokave shqiptare në Ulqin, Tivar, Hot e Grudë. Faqe të tjera të lavdishme janë edhe krijimi i "Djelmënisë së Shalës" në vitin 1890 nën drejtimin e Mehmet Shpendit. Djemtë e Shalës e të gjithë Dukagjinit morën pjesë në përpjekjet për pavarësinë kombëtare përkrah Dedë Gjo' Lulit e Bajram Currit. Këto bjeshkë krenare kanë qenë historikisht një bastion i qëndrueshëm përballë rrebesheve të historisë. Në përlshje të përgjakshme me ushtritë malazeze, në korrik të vitit 1915 dhanë jetën 104 luftëtarë të kësaj krahine.

Edhe në vitet e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dukagjinasi u shquan për patriotizmin dhe atdhedashurinë e tyre, duke u hedhur në luftë kundër pushtuesve. Më 5 nëntor të vitit 1943 ata krijuan çetën partizane të Dukagjinit, e cila në ditën e saj të parë pati 32 luftëtarë. Pikërisht në këtë vatër që e kishte

përherë të ndezur prushin e lirisë e të dashurisë për atdheun, do të spikaste edhe një derë e madhe e një familje e shquar nga Brashta e Shoshtit të Dukagjinit, familja e Gjon Marashit. Gjon Marashi do të ishte vazhduesi dhe transmetuesi i denjë i atyre vlerave të kreshnikëve e trimave të mëparshëm të historisë. Krijuesi Prelë Milani e përshkruan kështu këtë trim të maleve të Dukagjinit: "Një burrë sa fin aq edhe madhështor, me temperament e me ndërgjegje të zhvilluar kombëtare, me një zgjuarsin natyrore për t'u adhuruar nga gjithkush, me një bukuri fizike për t'u lakmuar edhe nga zanat e malit". Ndërsa poeti Hysni Milloshi shkruan: "E kam njohur Gjon Marashin në një konferencë kombëtare veteranësh në qytetin e Korçës. Ai kishte një pamje të mahnitshme malësori, si i lindur e rritur prej Nënës Orë".

Edhe trangu familjar i Gjon Marashit, kishte traditat e tij të hershme të trimërisë, besës e burrërisë. Babai i tij, Marash Pjetrushit, ishte kushëri i parë me një figurë tjetër legjendare të Dukagjinit, si Marash Tuci. Legjenda e tij u shkrua në pranverën e vitit 1806, kur Valiu i Shkodrës kishte thirrur në besë prijësat krenarë e trima të Nikaj – Mërturit, Ruc Ulën e Bash Vatën. Thirrja e tij nuk kishte qëllime mikpritëse, por prerjeje në besë, për t'u këputur atyre kokat si rebelë ndaj regjimit turk. Marash Tuci e kuptoi që Valiu po ja përdhoste e shkelte besën, ndaj u hodh si shqipe kundër asqerëve turq për mbrojtjen e dy trimave e luftoi derisa u vra. Një akt sublim në mbrojtje të besës proverbiale shqiptare, të njohur edhe tej kufijve të Shqipërisë. Albanologu i shquar Franc Nopça, duke shkruar për

Dukagjinin, thoshte: "Po të jesh në besë, në asnjë vend tjetër të botës nuk do të ishe më i sigurtë".

Këtë gjak patriotizmi kishte ndër deje edhe Gjon Marashi dhe familja e tij. Ishte ende i ri, 15 vjeç, kur u rreshtua bashkë me vëllezërit e tij më të mëdhenj, Kolën e Mëhillin përkrah luftëtarëve të tjerë në përpjekjet për pavarësi. Kurorëzimin e tij të parë në betejë ai e pati në korrikun e vitit 1915 në Qafë të Agrit kundër forcave malazeze të kryesuar nga Veshoviqi. Më vonë ai ishte kundër regjimit të Zogut, në përkrahje të Fan Nolit. Zogu e kishte dënuar me vdekje dhe i kishte ngritur disa herë kurthe për ta vranë, por nuk ja arriti qëllimit. Gjon Marashi ishte komandanti i Çetës së parë partizane të Dukagjinit dhe komandant kompanie në batalionin "Perlat Rexhepi". Edhe vëllai i tij, Mëhilli, ishte aktivist i Luftës Nacionalçlirimtare. Pas çlirimit, Gjoni ishte aktivist i pa parti në rindërtimin e vendit. Në kongrese kombëtare veteranësh apo të Frontit Demokratik binte në sy xhamadani i tij i kuq, i qëndisur me fije ari e me gajtana, i zbukuar me dekoratë e shumta që i mbushnin gjoksin. Në vitin 1980 ai u tha Enver Hoxhës e Ramiz Alisë: "Tani jam burrë i vjetër, mos më thërrisni më nëpër kongrese e kuvende. Në vendin tim thërrisni Bal Markun (Milanin), burrë mjaft i mirë e me zë në tërë Dukagjinin". Edhe ky fakt është një shprehje e zgjuarsisë së malsorit e mbase duhej t'u vlente si shembull atyre figurave politike që nuk largoheshin nga pushteti edhe atëherë kur kishin filluar të rridhnin nga trutë e të bëheshin objekt barcaletash në popull.

MARTIN CAMAJ - NDERI I KOMBI

Ditë vjeshte në histori metë
Dielli shndrite, kohë e qetë
Sot Shkodra çue herët
Atmosfera gëzimi, kthye në festë
Zemër hapun, prët birin e vete
Me nderime e respekt
Ndeje me vite në emigrim
E po kthehet me nderim
Jehone të madhe dhe nderimi
Përsëndet Shkodra e Dukagjini
Patriot e atdhetar
Historian e shkrimtar
Rozafati dhe Cukali
Si zakon e ka shqiptari
Dhe shoqatat e diasporës
Të Malit të Zi e të Kosovës
Me respekt e falënderime
Për rikthimin në vendlindje
Vlere e madhe e kombit tone
Emnin shqipes ia naltëson
Punove, o t'i në emigrim
Për shqiptaret asht frymëzim
Albanolog e poet, kurr su ndal
Lind në Telume, krahina Temal
Familje e njoftun me taban
Me burra trima për nder e vatan
Në Temal patriot me vlera
Burrë kreshnik Dede Shan Deda

U dallue në balle t' kuvendit
Përfaqësues në lidhje t' Prizrenit
Ku Martini merr frymëzim
Rrite dëshira për shkollim
Baba Kole i dha guxim
Me vështirësi, por me besim
Me mundime muer shkollim
Punoj mësues n' arsim
N' kohen e jetës së lulëzimit
Ra fantazma e trishtimit
Diktatura e regjimit
U shkruet në listat e dyshimit
N' listat e zeza të sigurimit
Ju krijuen kushte t' randa
N' arrati ose n' pranga
Muer vendim jashtë dëshirës
Me lanë prindit e token e Shqipnise
Muer rrugët e arratisë
Plot me vuajtje e merzi
N' kampe e n' burgje të Jugosllavisë
Në Itali shkoi më vonë
Nise studimet tanë përvojë
Për shume vite n' Gjermani
Fitoi status e nënshtetësi
Po i sjell jeta plote kujtime
I kthej vuajtjet n' përparime
Muer diploma e gradime
Në detyra me randësi

Shkenca të ndryshme e gjuhësi
Kalojnë vitet e shtohen mallet
Shkruen për lashtësinë e shqiptaret
Për londinat e livadhet
E lumenj, kreshtat e malet
Për djem e vasha t' reja
E bukuritë që sjell Pranvera
Babe e nane, vllazen e motra
E andërrimet që i vrau koha
Për gëzimet, festat e mortet
E traditat dhe zakonet
Episode e stinët e motet
Kalue moshë e lodh mërzi
Po gjithnji i rritet dëshira
Dite të mira me gëzue Shqipnia
U ba shkrimtar i nderuem
Me burrat e kombit asht rreshtue
Me shpirt e zemër po t' presim
Vlerat kurr s' do t' vdesin
Do ta rrujë gjithmonë aftësinë
Në mendjet tona rujnë freskinë
Të kam dashtë e admirue
Vlerat vone ti kam shijue
Se regjimi s' te ka vlerësue
Si patriot detyrën e kreve
Me vlera u riktheve
Letërsinë na pasurove
Solle gëzime e emocione

Me veprat tueja na befasove
Po pushon në vend të nderit
Te biblioteka e Universitetit
Thesari i kulturës së qytetit
Me student e profesor
Në përjetësi të kane simbol
Në kohen e rand të emigrimit
Ruejte shpresën e riatdhesimit
Dëshire shpirtit, lanë amanet
Si shqiptaret në kurbet
Amanetin tuej të madh
Që e kishe në shpirt e mend
Me nderime ta çuen në vend
Ketë dite feste e pëdurimit
Shoqata Atdhetare e Dukagjinit
Me shqiptaret e emigrimit
Në Evrope e Amerike
Kontribuen për ketë dite
O poeti biri i ksaj nane
Histori shkrove, histori bane
Nderove kombin e veten tande
I përjetshëm o kolosi i letërsisë
Në piedestalin e pavdekësisë.

*Pjeter Geraj,
Belgjike,
dhjetor 2015*

SOFRA E SHQIPES 2016 SHTROHET NË NEW YORK

Në traditën që Art Center "Blue Sky" po krijon që prej katër vitesh një format për bashkimin e shqiptarëve në festat e fundvitit, është spektakli "Sofra e Shqipes". Këtë radhë vendosi ta shtrojë në Amerikën e largët, në Neë York për bashkëatdhetarët dhe miqtë e tyre që jetojnë atje.

Kjo sofër e madhe u shtrua siç shtrohet në çdo familje shqiptare, në çdo dasëm e gëzim, ku këndohet, vallzohet e gëzohet vetëm shqip.

Për të realizuar suksesin e këtij eventi, presidenti i Art Center "Blue Sky" z. Gëzim Brahusa kishte ftuar këngëtarë dhe artistë të shquar nga elita e gjithë trevave shqiptare, në bashkëpunim me kompaninë e spektakleve "Albis Party" me president z. Naser Nika.

Kjo darkë e gëzueshme u organizua në Neë York, në "The Grand Prospect Hall" në Brooklyn, një sallë madhështore që është ndër-tuar në vitin 1892 dhe nga kjo sallë janë pritur e përcjell mijëra artistë ku kanë shfaqur koncerte të ndryshme, filma, muzikë, teatro, balet, etj. ku do të kishin nderin të performonin edhe artistë nga trevat shqiptare.

Kjo sallë këtë natë ishte shtëpia e shqiptarëve që kishte shtruar një sofër me mysafir dhe me artistë të mrekullueshëm, ku me këngë, valle e humor i ngritën dolli me aromë shqipërie.

Pas suksesit që "Blue Sky" me stafin e tij arriti për tre vite me radhë në organizimin e "Sofrës së Shqipes" për festat e fundvitit: të parën në qytetin e Shkodrës, të dytën në qytetin e Ulqinit dhe të tretën në qytetin e Prizrenit në Kosovë, këtë radhë Shqipja e kësaj sofere fluturoi drejt Neë Yorkut për një koncert madhështor, i cili i shfaq në "The Grand Prospect Hall" Neë York, në bashkëpunim me "Albis Party".

Ishte një program tejet i pasur me këngë, valle e humor me artistët më në zë nga të gjitha trojet shqiptare, nën drejtimin e ikonës së ekranit shqiptar, Silvana Braçe, e cila në saj të elegancës dhe komunikimit të saj të ëmbël, e njohur në sa e sa spektakle e koncerte në Shqipëri e Diasporë, kësaj here ishte "Zonja" e TV "Blue sky".

Për të katërtin vit rradhazi TV "Blue Sky" prezantohet me "Sofrën e Shqipes", një arritje që do ta quaja në radhë të parë: Bashkimi Kombëtar, ruajtja dhe kultivimi i folklorit të bukur shqiptar dhe transmetimin e tij brezave, pra fëmijëve në diasporë. Kjo ka sjellë atë që interesimi i këtij televizioni, është që mos të harrojmë vlerat dhe traditat tona edhe në kurbet, duke kontribuar në mënyrë shumë artistike

dhe të suksesshme, në prezantimin e një mozaiku këngësh dhe veshjeve të mbarë trevave shqiptare.

U krijua një atmosferë dhe entuziazëm ku përmes pjesmarrjes u ndërthuren shumë bukur muzika dhe humori, duke performuar edhe me orkestren e përbërë nga instrumentistë të talentuar dhe profesionistë, nga një krahinë në tjetrën, nga Jugu në Veri, duke u përshtatur sa më mirë, për të treguar se shqiptarët që jetojnë jashtë atdheut, deri në Amerikën e largët, festojnë së bashku me vëllezërit dhe motrat e tyre të një gjuhe dhe të një gjaku, për të treguar se edhe në botën e largët po mundohemi t'i ruajmë dhe mbajmë brez pas brezi këto vlera folklorike kombëtare, vetëm shqiptare, duke i prezantuar në mënyrën më dinjitoze.

Përmes duartrokitjeve të gjithë këngëtarët me radhë u prezantuan sipas krahinave. Programin e hapi këngëtarja shkodrane Alma Velaj, e cila gjithmonë ka qenë e hijshme, elegante dhe e suksesshme në skenat shqiptare aq sa nuk mund të mendohet një program apo koncert pa zërin e saj. Atmosfera e kësaj sofere u ndez edhe më shumë kur në skenë doli këngëtarja Suad Shaptafa, i cili përfaqësonte Ulqinin.

Më pas këngëtarja e re Egzona Salaj me zërin e saj të bukur dhe me interpretimin brilant, përcolli emocion dhe kënaqësi të veçantë që i buronin nga shpirti, duke e përjetuar fuqimisht me mjaft mjeshtri, pra ajo është vërtetë një artiste e pakrahueshme në skenë dhe ekran.

Egzona është një këngëtare me një niv-

Këngëtarja ulqinak Hajro Ceka me banim në SHBA, artisti që ndan famën mes Shkodrës, Ulqinit dhe Neë York-ut, shpërtheu si uragan me zërin dhe interpretimin e tij live, plot pasion, i shoqëruar nga djali i tij Sammy Ceka, grupi muzikorë "Ceka" shoqëruar nga Vebi Spahiu në fizarmonikë dhe Gjovalin Shkreli klarnet-saks, duke krijuar një atmosferë të këndshme në sallë me një performancë të rrallë të këtij këngëtarë që i shkëlqejnë sytë dhe i buzëqesh fytyra, duke bërë për vete publikun me zërin e tij të veçantë.

Hajro Ceka është një përfaqësues dhe përcues i denjë i këngës shqiptare në komunitetin e bashkëatdhetarëve tanë në Amerikë dhe si një mësues i mirë përcipet t'i transmetojë ato dije dhe vlera që ka tek rinia, ku një ndër nxënësit e tij është edhe i biri Sammy.

E kështu njëri pas tjetrit vazhduan këngëtarët me radhë: Eli Fara, Kleoparta Dokle, Elisabeta Marku, Gëzim Salaj, Agron Maqellara, Vitor Hila, Nike Çarku e të tjerë.

Në këtë mbrëmje magjike krahas këngëve e valleve, ndërthurej edhe humori i papërsëritshëm shkodran nga aktori i mirënjohur Besnik Çinari dhe Bujar Ademovi, të cilët u priten me duartrokitje të ngrohta. Në këtë sofër ishte i ftuar edhe humoristi nga Tirana Ermal Mamaqi që me performancën e tij i dha gjallëri kësaj sofere, si një "tiranasi" mik në sofren shkodrane.

Disa media dhe gazetarë u angazhuan rreth këtij spektakli, jo vetëm për të përcjell tek publiku suksesin e kësaj sofere të madhe shqiptare, por për t'i pasqyruar çdo detaj dhe emocion që do të mbesin të paharruara nga çdo pjesmarrës i asaj nate "madhështore" në Neë York.

Shumë adhurues të folklorit shqiptar, të trashëgimisë kulturore e muzikore, ndër të cilët isha edhe unë, i ftuar nga Kompania e spektakleve "Albis Party" në Neë York, me president z. Naser Nika, u ndjemë krenarë, jo vetëm për qëllimin e këtij aktiviteti, por edhe për realizimin e tij në të gjitha nivelet.

Këtë pjesmarrje duhet ta konsiderojmë të suksesshme për shumë arsye, dhe më kryesorja është ruajtja dhe trashëgimi i vlerave kombëtare, e cila mund të realizohet më së miri përmes këtyre aktiviteteve, të cilat çojnë një copëz nga Shqipëria tek bijtë e saj që janë larg.

Dhe kjo sofër këtë vit u shtrua atje. Atje ku një copëz Shqipërie, e sjellur nga Art Center "Blue Sky" mbledhi për të festuar ata që në pamundësi të vinitin në atdhe, do ta ndjenin veten njëlloj si në vendin e tyre

**Përgatiti Ramazan Çeka,
New York 2015**

Shqiptarët e Amerikës që u përfaqësuan në këtë sofër të kësaj nate e gjitha shqiptare ishin të shumtë. Të ftuar special mes shumë këngëtarësh dhe artistësh, ishte edhe SHKA "Ana e Malit", duke krijuar një atmosferë dhe emocion të jashtëzakonshëm për publikun.

el të lartë artistik në interpretimin krejtësisht të veçantë të këngës popullore dhe në realizimin brilant të këngëve ulqinake me të cilat ajo u rrit, duke qenë kështu një pasardhëse e denjë e të atit Gëzim Salaj, një këngëtar mjaft popullor në zonën e Ulqinit dhe Shkodrës.

... I SHKRETI ...

- KOMENT -

Mu kujtua një shprehje që unë e kisha dëgjuar mbi gjysëm shekulli më parë. Mbase më nxit mendimet ndonjë veprimtari dhe qëndrime në shkrime të ndryshme të shtypit, pse jo edhe botime librash.

"Nuk dua që të më thonë gjithkush "i shkreti", dua që dikush edhe të me thonë "mirë e ka qeni", sepse kjo më jap zemër, më shtojnë inatin për më mirë, për të mos u dorëzuar kollaj, për tu ngritur, për të mos u rrëzuar", pata dëgjuar një herë gjyshin tim në atë kohë.

"I shkreti malësor", "i shkreti fshatar", "i shkreti", "fukarai", "i padituri", "inJORanti", "i trashi", "i varfëri", "naivi", etj. të kësaj natyre janë përdorur, por edhe po përdoren sa herë që një kalemxhiu i duhet që të shkruaj diçka për këto zona, dhe këta banorë, dhe kjo më shumë se sa për të treguar dhimbjen, bëhet për tu dukur i vëmendshëm, i shqetësuar, për tu dukur se jeton me këto vështirësi, me këto zona, me këta banorë, me hallet e tyre. Të tillë kalemxhinj i paraqesin banorët si simbol i viktimës, të përbuzur, të pafuqishëm, por kur i duhen, madje pikërisht shumë nga këta, i paraqesin edhe si heronj, trima, të vendosur, reformator, të fuqishëm, bujar, atje hahet mirë, jetohet mirë, ka mjedis të pastër. Është karakteristikë e malësorit që të flasë shkurt, shpejt dhe qartë. Kështu është formuar gjatë kohës, sepse nuk ka pasur shumë kohë dhe mundësi, për vetë kushtet ekonomiko-shoqërore dhe natyrore, që të bisedojë ngeshëm, të shpenzojë shumë kohë, prandaj flet hapur, dhe me fjalë të thjeshta, të cilat i merren, shpesh, ose si ta kërkojë nevoja, si naivitete, madje edhe nga ata që "e kanë për zemër" malësorin a fshatarin. Jo zotrinjë, fshatari, malësori nuk është aq i prapambetur sa e mendojnë këta, por ndokujt i duken si të tillë nga sinqeriteti i tyre. Malësori është, disi, i vonuar, sepse kështu i ka pasur kushtet, për jetesë, për shkollim, për kulturë, dhe për këtë vështirësi nuk përjashtohen as ata që "përgjërohen" për malësorin apo fshatarin në tërësi, e që i kanë si "fishek afër vajnicës" sa herë ju duhen portrete, figura, personazhe, luftëtarë, heronj, viktimë, të përlulur, të përbuzur, të krrusur, viktimë. Mirë, se, të tillë ka kudo, por kur shikohen përdorime me vend dhe pa vend të këtyre figurave në piktura, letërsi artistike, fotografi, studime, etj., nuk shikohet dhe nuk ka ngrohtësi brenda tyre.

Po realizohen botime jo të pakta ku paraqitet jeta dhe mënyra e jetesës së banorëve të zonave rurale, dhe kjo, është pozitive, por kur shikohen denigrime, zhveshje nga virtytet e veta dhe veshja e të tjerave, vendosja e negatitës në qendër të vëmendjes, vendosja e ngjarjeve të huazuara nga zona, krahina apo fshatra të tjera me qëllim për tu paraqitur si më i fuqishëm përpara lexuesit nuk ndikojnë për mirë. Po ndodhë që vetë ata që dikur shkruanin me aq pasion, me aq frymëzim, me aq pompozitet, po përsëritin vetveten, por tash me drejtim të kundërt, tash me ngarkesa negative. Një herë bëhen lavdërime, ngrihen himne, e më vonë, për të njëjtën ngjarje apo person, bëhen kritika dhe denigrime, në vartësi të situatave politiko shoqërore. Edhe kjo mund të bëhet, por nuk është se tregon ndonjë gjë me rëndësi. Në jetën e përditshme takohen raste apo persona që paraqiten herë si viktimë dhe herë si heronj apo udhërrëfyes, kërkojnë ndihmë për çdo gjë e vazhdimisht; "ma jep atë", "më sill këtë", "ma jep dorën", "bëje punën kështu, apo ashtu", "jo lart e poshtë, por, poshtë e lart", "shtyju më tej", "eja më kënde", dhe madje kërkojnë që të zbatohen mendimet e tyre pa thënë "pse", pra në një kuptim kërkojnë gati "skllever" në punë e në mendime, e, madje nga "sklleverit" e mendimeve duhet pasur shumë kujdes. Natyrisht është e drejtë e tyre, por kohët kanë ndryshuar, dhe lexuesit e dëgjuesit kanë të drejtën e tyre për të njohur, menduar, folur dhe reflektuar.

Ka edhe nga ata që thonë, madje trumbetojnë së kjo zonë, apo ajo tjetra, duhet të ruhet nga ndikimet e bashkohores, të ruhen ndërtimet ashtu siç kanë qenë dikur, të ruhet ajo mënyrë jetese, madje edhe ato marrëdhënie shoqërore, kjo e fundit nuk thuhet fort hapur por kur na u deshka që të jetohet si dikur, atëherë edhe marrëdhëniet shoqërore duhet të jenë të tilla. Por a mund të realizohet një gjë e tillë, sot, që zhvillimi në shkallë botërore ka arritur nivele të pa imagjinuara. E gjithë kjo mendohet dhe trumbetohet që ti shërbejnë turizmit, të tjerëve, që të kënaqen me trashëgiminë tonë, të shikojnë se si kanë jetuar të parët e tyre, por që sot nuk i kanë atje, dhe as që duan ti restaurojnë, e as ti muzealizojnë, por i duan këtu. Ka pasur raste, që kemi dëgjuar, hapur, të jenë shprehur se nuk duhet të përmirësohet rruga e makinës, të mos shtrohet më asfalt, etj. sepse kështu e duan ata që duan të lëvizin me motorra, në këmbë apo me makina malore, etj. etj. Kjo e fundit është shprehur edhe nga shqiptar, madje edhe ndonjë banorë i zonave, apo qytetas, jo shumë kohë më parë, për të cilën është reaguar kohë më parë.

Po për kë punojmë, për kë ndërtojmë, për kë kërkojmë përparimin, për veton tonë e fëmijët tonë apo që tju bëjmë qejfin të tjerëve, qofshin këta turist, apo aventurier të ecjeve malore. Ne duhet të ndërtojmë në mënyrën më të mirë të mundshme, në përshtatje me kushtet, duke ruajtur traditën maksimalisht, duhet të ruhen ushqimet natyrore tradicionale, por natyrisht nuk mund të sërviem në bluda prej druri dhe të hanë me lugë prej druri, në mënyrë kolektive, në sofrë dhe të ulur në fier, kashtë mistri ose fare për tokë. Koha ecën dhe nuk kthehet prapa. Duke menduar mbi këto që u thanë këtu, atëherë çfarë mund të kumtojë shprehja; "është i mirë i shkreti", përveç se afërsisht; "po të them një rrënë të saktë, ti je burrë i mirë".

Të tilla mendime, apo vlerësime bëhen, me sa duket, duke menduar se atje, në ato male, në ato fusha, në ato zona, gjithçka thuhet në qytet duhet të pranohet. Vërtetë kultura hyn e del përmes derës së qytetit, por kudo ku jetojnë njerëz ka kulturë, ka traditë, ka norma e zakone që janë krijuar në një kohë shumë të gjatë, dhe këto duhet parë e vlerësuar në kohën dhe hapsirën e tyre. Mbase ka shumë raste që historia dhe kultura ose elemente të tyre, janë më të thella në histori në zona rurale, qofshin këto zona malore apo fushore, se sa në shumë qendra urbane, prandaj nuk ka se si të mos vlerësohen e vendoset ku e meriton.

Mëshira me fjalë, ndihmat e ashtu quajtura humanitare, lëmosha, vlejnjë për momentin, por, nuk të qesin në anë. Njerëzit duan punë, vlerësim, drejtësi, hapësirë, që të përmirësojnë vetë jetën e tyre.

Luigj SHYTI

PROMOVOHET NE BRUKSEL LIBRI ME I RI I AUTORIT LEK PREVIZI "DANS LES CERCLES DE L'ENFER" (RRATHET E FERRIT)

Në ambientet e qendrës kulturore "Flander" Bruksel u zhvillua promovimi më i ri i autorit Lek Previzi i titulluar "dans les cercles de l'enfer" (Rrathet e Ferrit) botuar nga shtëpia botuese franceze Harmaten. Në këtë ceremoni marrin pjesë intelektual shqiptarë nga gjithë hapësirat shqipfolëse, që jetojnë në Bruksel, botues si dhe përfaqësues të mediave shqiptare dhe të huaja.

Në titullin e librit autori ka vendosur gjendjen e mjerueshme që kalonin intelektualët shqiptarë dhe familjet e tyre në kampet e regjimit komunist në Tepelenë, kampi i cili u be një vorbe vdekjeprurëse për qindra gra, burra, e fëmijë shqiptarë. Autori, Lek Previzi vjen në këtë botim të ri pasi nuk rresht asnjë ditë duke punuar për një krijimtari të gjere artistike. Lek Previzi ka lindur në Guraj të Kurbinit, në vitin 1929 dhe ka jetuar në kampet e përqendrimit rreth 25 vite. Nga viti 1990 jeton në Bruksel. Nga viti 1993 boton revistën "Kuç e Zi", ka botuar vëllimin me poezi të burgjeve e kampeve (shqip, italisht, frëngjisht). Ka përkthyer nga italishtja e vjetër veprën origjinale historia e Gjergj Kastriotit-Skënderbeut të autorit Dhimiter Frangut. Është autori i mjaftë botimeve dhe i krijimeve të ndryshme letrare, ku akademia internacionale "IL CONVIVIO SICILIA ITALIA" e ka shpallur fitues Lek Previzin me përmbledhje poezish me çmim special për vitin 2009, si poetin më të mirë të huaj.



Promovimi i librit "rrathet e ferrit" u moderuar nga zonja Shqipe Duro, e cila krijoi një mjedis të veçantë duke shfaqur një montazh filmik për jetën e Lek Previzit. Redaktori i librit Safet Kryemadhi cilësoi karakterin e rrëfimit në këtë libër si origjinal i përjetuar nga vete autori. Më pas, një analizë të hollësishme e beri publicisti Gjovalin Kola, i cili nder të tjera u shpreh: "Autori shkruan me sinqeritet duke përcjell ngjarjet e momentet më të vështira të një epoke të diktatures. Disa krime makaber po vinë edhe në ditët e sotme, Leka e ka shprehur në piktura, poezi, përkthime, por në këtë libër do të cilësoi poemën e bukës, aty mësojmë se i vdekuri lihet tre dite për të marre racionin e bukës ..." Në këtë aktivitet ka përshëndetur dhe bashkëvuajtësi në kampet e përqendrimit. Myrteza Bajraktari, i cili vlerëson autorin për vërtetësinë duke cituar se, të gjithë diktaturat kanë të njëjtën fytyrë ... Të pranishmit i ka përshëndetur dhe përfaqësuesi i ambasadës shqiptare në Bruksel z. Jorgji Koto. Kjo veprimtari u përcjell me interpretimin e poezive nga Shqiponja Duro në gjuhën holandeze, Jeton Kelmeni në shqip dhe Elona Zhana frëngjisht. Muzika nga Gjovalin Nonaj. Kjo veprimtari u mbyll me diskutime dhe përshëndetje të shkrimtareve Iranian dhe Belge, duke përgëzuar autorin për punën e tij në prag të 80 vjetorit të lindjes.

Përgatiti për gazetën Dukagjini
Zef Nika, Bruksel 2015

SOFRA SHKODRANE 2016

Në jetën e përditshme të qytetit të Shkodrës, kënga popullore shkodrane është gjithmonë e pranishme, si një ushqim shpirtëror e frymëzues, sepse kënga dhe humori janë pjesë e pandashme e banorëve të këtij qyteti.

Organizohen çdo vit koncerte, spektakle, sofrë me këngë dhe humor, por të gjitha në përformancat e tyre kanë një bazë të vjetër tradicionale që në kulturën shpirtërore njihet si ahengu shkodran.

Agjensia e spektakleve "Jehona e Shkodrës" në bashkëpunim me Radio Televizionin Shqiptar me regjisor "Mjeshtër i Madh" Osman Mula, mjeshtër i magjisë skenike dhe televizionit, i cili respektohet e nderohet nga Shkodra me krenari përkrah titanëve të artit shqiptar që "brumosi" ky qytet, si dhe Star Plus, Televizion në Shkodër, organizoi spektaklin tradicional "Sofra Shkodrane" edicioni i psëmbëdhjet, me rastin e festave të fundvitit.

Në këtë natë festive morën pjesë këngëtarët e mirënjohur shkodranë: Bujar Qamili "Mjeshtër i Madh", Frederik Ndoci, Adnan Bala, Orjeta Kelaj, Klodiana Vata, Elidon Çela, Vjollca Luka, Gjovani, etj.

Këtë spektakël tradicional më të këndshëm dhe më me atmosferë festive e bënë humoristët e shquar shkodranë: Gëzim Kruja "Mjeshtër i Madh", Zef Deda "Mjeshtër i Madh", Drande Xhaj, Anton Krosaj, Muhamet Çekini, Eder Boshnjaku dhe Fric Selmani.

Sofrën Shkodrane e shoqëruan grupi i valleve "Aldo Dence Group", të ftuar

ar special nga Apartamenti 2XL Julian Deda dhe Albano Bogdo, moderatore aktoria e Teatrit "Migjeni" Raimonda Marku dhe Ergys Bamçi, Regjisor Zef Deda, producent Xhelal Halili.

Sofra Shkodrane u organizua në kompleksin "Orlando" në Shkodër ku

magjike, ngjasonte me dasmat tradicionale shkodrane që bëheshin dikur në oborre, ku ashikë e dashmirë të këngës rrinin me orë të tëra për të shijuar magjinë e ahengut shkodran.

Ishkujnë këtij qyteti këto lloj festash, këto manifestime sa të bukura aq dhe kulturore e shpirtërore, siç i ka hije "Sofrës Shkodrane" me ritme e hove rinore.

"Sofra Shkodrane" tregoi se di ta ruaj traditën e bukur të këtij qyteti të shquar të artit dhe të kulturës, duke përformuar live disa nga kryeveprat e kësaj tradite.

Një vlerë e veçantë e këtij aktiviteti të bukur ishte edhe libreti i punuar me mjeshtri nga aktorja Raimonda Marku, e cila nuk është hera e parë që reflekton për vlerat e "Sofrës Shkodrane", por dhe të krijuesve shkodranë. Që në prezantimin e saj të parë u përçollën emocione që spektatorët e pranishëm kishin kohë pa i shijuar. Ishin këto vlera të interpretuara live dhe me mjeshtri me instrumenta karakteristike popullore, me zëra të mrekullueshëm të artistëve shkodranë e kombinuar me veshjet tradicionale të qytetit.

Duhet të evidentojmë se shkodranët, përfaqësuesit e muzikës qytetare shkodrane në të kaluarën edhe sot, mbi traditën e këngës popullore kanë krijuar dhe krijojnë edhe këngë të reja, të cilat për nga format dhe karakteristikat bëhen pjesë e kësaj pasurie të madhe.

Për ta mbajtur të gjallë këtë traditë, për të mbajtur në formë interpretuesit e vjetër dhe për të sjellë zëra të

rinj, Agjensia e spektakleve "Jehona e Shkodrës" hodhi hapat e parë për të krijuar edhe ajo vetë një traditë, që tradita e vjetër të mbetet e gjallë, autentike, por edhe e freskuar me interpretues të rinj që janë pikërisht ata sot përfaqësues të këtij burimi të pashtershëm.

Për t'i dhënë vlera tradicionale këtij eventit kaq të dashur e të bukur, u angazhua me një pasion shumë të madh producenti i Agjensisë së spektakleve "Jehona e Shkodrës" z.Xhelal Halili, i cili tha: "Synimi është që të ruhet kjo traditë e bukur dhe të pasurohet më tej për t'ja çuar brezave të rinj të pastër dhe origjinale "Sofrën Shkodrane".

Për këtë aktivitet kaq emocionues, por edhe të rëndësishëm të qytetit të Shkodrës, do të prononcoheshin edhe përfaqësues të shquar të jetës kulturore e artistike. Presidenti Unionit Artistik i Kombit Shqiptar z.Azgan Haklaj "Mjeshtër i Madh" i cili prej 9 vitesh e mbështet këtë veprimtari, me shumë përmallim u shpreh: "Sofra Shkodrane" po bëhet një traditë e bukur. Edhe sivjet u kënaqem dhe u përmalluam me këngën shkodrane që nuk vdes kurrë.

Sa mirë do të ishte që në rreshtat e parë të sallës të shihnim ata që i dhanë jetë këngës shkodrane dhe e ngritën aq lart. Mos i harroni ata, ju që organizoni koncerte kaq të bukura. Prania e tyre ia shton bukurinë këtyre veprimtarive. Shkodra gjithmonë ka patur vlera të tilla që e them me bindje se nuk mund t'i ketë çdo qytet".

**Përgatiti Ramazan Çeka,
Dhjetor 2015**



ishte mbushur si rrallë herë me spektatorë artëdashës, siç mbushet një bahçe me lule të bukura në pranverë. E veçantë dhe pozitive ishte se përveç dashamirësve të moshuar të këngëve popullore qytetare shkodrane, freski i jepte audiencës moshë e re e spektatorëve, djem e vajza shkodrane që shpesh pa të drejtë "akuzohen" se rendin pas muzikës moderne dhe harrojnë se qyteti i tyre ka këngë shumë të bukura.

Kjo festë e vërtetë, kjo mbrëmje

MËSUESIT NË PENSION

Ditë e gëzuar në veçanti,
Të sollë në kolektivin tonë ty,
Të uroj veç lumturi,
Bekim të jap me krenari.

Mendo mirë, mos harro,
Kolektivi prap të do,
Të mirin e kujtojnë me dashuri,
I vlerësuar je për ndër Ti.

Vlerësimet janë të larta,
Janë më të ëmbla së mjalta,
Ndërimet tona me lëvdata,
Janë surpriza të forta, të ëmbla.

Mendo vitet e punës me ne,
Jeton me ngrohtësi dhe ndere,
Shokët e mirë të kanë në zemër,

Edhe pse je larg, të kujtojnë me emër.

Kujtimet janë madhështore,
Dëshirat e jëtës plotësive,
Pati mirësi, pate fitore,
Me lëvdata në pension dole.

Mos u mërsit, por beko,
Të duam ty, mos na harro,
Pleqëria tek ti nuk zë vend,
Njeri i lartë përnjimend.
Vitet kalojnë, kujtimet mbesin,
Me respekt ty të përshendesim,
Përshndetje më stiumul të lartë,
Mësues je ti shumë i begatë.

Begati paç si yjet e Qiellit,
Lumturi paç si drita e Diellit,
Në mes lulësh pranverore,
Jetofsh i lumtur, shëndet dhe fitore.

NË DUKAGJIN, BURRAT JETOJNË

Vinë nga bjeshkët e burrërisë,
Vinë me fladin e freskisë,
Vinë nga Lulet e lënaqësisë,
Vinë nga Dukagjini i burrërisë.

Burrat klindin dhe këtu rriten,
Se harrojnë kurrë traditën,
Rriten në bjeshkë si luana,
Lindin trima sikur zana.

Si luana, t'fortë si shkëmbi,
Lum për trimat që ka vatani,
Janë linë ndjep me psushkë te koka,
Trima të fortë që i njeh bota.

Shqipja e malit n'atë vend rritet,

Historia për burra flitet,
Jeta e trimave, pushkë e flamur,
Trimat e shqipes rriten mbi gur.
Sa i fortë guri shekullor,
Historia krenare gjithmonë,
N'Dukagjin burrat jetojnë,
Trimat shqipes nuk i mungojnë,

Sa zë t'ashpër si çeliku,
Për trimëri i njeh armiku,
Kullat tona janë ba kala,
Pa nder malet kurr s'janë nda.

Gryka e shkrepë, bjeshkë me zanë,
Brejnë çelikon burrat me dhamë,
Historia e tyre është shekullore,
Të pavdekshëm, n'drejtimet njerzore.

**LUKE ZEFI
Shkolla vjeçare Vrakë**

FAMILJET FISNIKE SHQIPTARE NË KOPRIN E VENEZISË

- SIMPOZIUM ME VLERË NACIONALE -

Të shtunën me 26.09.2015 në Kopër të Sllovenisë mbajt me sukses simpoziumi për nder të familjeve fisnike Shqiptare në Koprin e Venedikut. Në këtë ngjarje shumë të rëndësishme që u organizua nga Shoqata kulturore shqiptare "ILIRIA" e Koperit në bashkëpunim me bibliotekën e Koperit ishin të pranishëm personalitete shumë të rëndësishme siç janë kryetari i Koperit z. Boris Popoviq, ministri i diasporës z. Valon Murati, ambasadorët e Shqipërisë dhe Kosovës në Lubjanë mandej dr. Frashër Demaj nga Kosova, dr. Edmond Malaj nga Shqipëria, nënkryetari i Ferizajt Xhavit Zariqi, shoqatat nga Zagrebi, Pula, Rijeka, Poreçi, Trieste dhe nga Treviso. Ishte një ditë pas 300 viteve u shpalos historia e familjeve fisnike Shqiptare që kanë jetuar dhe vepruar në Kopër. U organizua edhe mesha e drejtuar nga misionar të kishës katolike me famë, në mesin e të cilëve edhe Dom Albert Krista, priftë katolikë shqiptar në Kroaci dhe Slloveni.

Për nder të këtij evenimenti, po të njëjtën ditë, u hapë edhe ekspozita e piktorit të njohur Gani Llaloshi, ku u mirëprit nga të pranishmit e kësaj feste të rëndësishme, me vlerë kombëtare.

Familjet fisnike shqiptare në Koprin e Venedikut ma të njohura janë: Familjet Bruni, Bruti dhe Bruni, etj.

Për mbajtjen e këtij simpoziumi, kontribut të ndryshëm dhan bashkatdhetarët tan që jetojnë e veprojnë në Kopër e rrethinë, sidomos ata që janë të mbledhur në aktivitete të Shoqatës Kulturore Shqiptare "ILIRIA" me seli në Kopër, e cila ishte edhe organizatore.

Hapjen e simpoziut e bëri zoti Hestet Ahmeti, kryetar i Shoqatës "ILIRIA" të Koprit, i cili në cilësinë e organizatorit u shpreh:

"Me ftesën e bibliotekës qendrore të Koprit, në muajin shkurt të këtij viti isha prezent në ceremoninë që shënonte përvjetorin e 300 të ndërtimit të pallatit Bruti në Koper, selia aktuale e bibliotekës qendrore. Me këtë rast, me plot kënaqësi mësova se, në ipeshkvin e atëhershme dhe selinë administrative, në kohën e Republikës Venedikase, ishin prezent disa familje me origjinë shqiptare. Përvjetori i pallatit Bruti përkoj me përvjetorin e pavarësisë së Kosovës, i cili nën kujdesin e Shoqatës kulturore shqiptare e Istrias sllovene "Iliria" Koper, u festua në Ankaran afër Koprit. Me këtë rast, së bashku me ministrat e Kosovës dhe Shqipërisë, si dhe me disa persona tjerë veprimtar dhe të fushës së kulturës, kemi rënë dakord, që në muajin shtator të takohemi përseri, pranë varrezave të monsinjorit ipeshkvi Agostino de Brutija dhe në mënyrë ceremoniale të përkujojme prezencën e familjeve fisnike shqiptare në Koper, të cilat kontribuuan që kryeqyteti venedikas i Istrias, metropoli "Capo d'Istria", të shënohet në hartën e diasporës shqiptare në bregdetin veri-lindor të detit Adriatik.

Për këtë arsye, me kënaqësi të

madhe pres publikimin, me të cilin dëshirojmë të zbardhim aktivitetin e ipeshkvi të Koprit Agostino dhe rëndësinë e familjes së kontëve Bruti, të cilët rrjedhin nga Durresi dhe Ulqini, dhe të cilët pas pushtimit turk të Shqipërisë venedikase në fund të shekullit 16, përfundimisht janë vendosur në Koprin venedikas. Kjo familje i la qytetit të Koprit një nga monumentet më

prezencën e familjes fisnike të kontëve Albanese, pak më vonë asaj i janë bashkangjitur edhe dy familje tjera fisnike të kontëve Brati dhe Albani. Më në fund, shkaku i prezencës së disa familjeve fisnike shqiptare emërohet edhe njëra nga rrugët e Koprit "Calle Albanese" (Rruga Shqiptare). Këtu jemi vendosur në periudha të ndryshme kohore për arsye të ndry-

shme politike ose shoqërore apo bindjeve fetare, edhe pse ne shqiptarët kryesisht jemi të njohur me aktivitete që kanë të bëjnë me gastronomi dhe ndërtimtari, por si popull ne jemi një komb i paraardhësve të kontëve, fisnikëve dhe emincave tjera të rëndësishme, të cilët kanë lënë gjurmë të dukshme dhe të prekshme anë e mbanë botës. Kjo është krenaria jonë për çfarë duhet të jemi shumë të vetëdijshëm.

Strukturat administrative dhe ushtarake të Republikës Venedikase kanë sunduar vendeve përtej bregdetit, "Io Stato da mar", dhe me ndihmën e fisnikërisë lokale, shqiptare, vendoset edhe Shqipëria Venedikase. Më vonë, për shkak të kërcënimit turk këto familje fisnike kanë qenë të shpërndara në vende të ndryshme, gjithashtu edhe në veri të detit Adriatik. Këtë ishin të detyruar

të bëjnë familjet fisnike Borisi, Bruti dhe Bruni, disa familje tjera kanë ardhur këtu nga kryeqyteti i Venecias, siç ishte familja Carpaccio, e cila në Koper kishte marrë porosi të mëdha, dhe më pastaj i kishte lënë qytetit veprat më të rëndësishme të pikturës.

Në këtë pikë, unë do t'iu kujtoja dëshminë e heshtur të shqiptarëve të thjeshtë, të cilët gjatë fatkeqësive të mëdha shëndetësore të mortajës në shekullin 17, u vendosën në periferin e Koprit, dhe me zell kanë ruajtur imazhin e frytshëm të Istrias. Të gjitha këto rrëfime pak a shumë të harruara, sot janë objekt hulumtues i ekspertëve vendor dhe të huaj, të cilat do të ndihmojnë në përforcimin e identitetit kombëtar, për arsye se e gjithë historia e migrimit dhe integritetit të njerëzve tanë,

pothuajse ka ndodhur në tokën e Koprit, përgjatë periudhave të ndryshme historike dhe autoriteteve të ndryshme udhëheqëse.

Ceremonia e sotme nuk do ishte pa pjesëmarrjen dhe donacionet e juaja bujare. Unë, sinqerisht do doja të falënderoja z. Valon Muratin, Ministër i diasporës i Republikës së Kosovës, Shkëlqesinë e Tij z. Pëllumb Qazimin, Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Sllovenisë, Shkëlqesinë e Tij z. Nexhmi Rexhepin, Ambasador i Republikës së Kosovës në Republikën e Sllovenisë. Falënderime të veçanta i takojnë monsinjorit dr. Jurij Bizjak, ipeshkvi ordinar të Koprit, për sakrificën e Meshës së Shenjtë në kujtim të ipeshkvi Agostino. Përzemërsisht falënderoj prof. dr. Edmond Malajn nga Qendra për Studime Shqiptare në Tiranë dhe dr. Salvator Zhitek, Shoqata Historike e Primorskes jugore Koper, për kontributin gjithëpërfshirës historik. Një falënderim i madh i takon z. Gani Llaloshit, piktorit akademik shqiptar, i cili me veprat e tija të ekspozuara në mënyrë artistike dhe vizuale ka përlëvduar dhe zbukuruar ceremoninë e sotme. Një falënderim i veçantë po ashtu i takon z. Boris Markezhit, gardian i manastirit Françeskan Shën Annes, për ambientin e manastirit, që na dha në dispozicion, në veçanti Galerinë për hapjen e ekspozitës së artit dhe pamje të mrekullueshme të kopshtit të manastirit për zhvillimin e programit kulturor. Së fundi, unë do të doja të falënderoja mag. Peter Shtoka, kurator i koleksioneve të Librave të vjetra të bibliotekës qendrore Koper, për redaktimin dhe botimin e këtij publikacioni, sepse personalisht Petri na tërhoqi vëmendjen për prezencën e familjeve fisnike shqiptare në Koper dhe mua personalisht më frymëzoi për organizimin e kësaj ceremonie përkujtimore. Për mbështetjen morale dhe përpjekjet e çmuara në përkthimin e këtyre botimeve në gjuhën shqipe falënderoj mikun tim të mirë Prof. dr. Martin Berishën, dekan i Fakultetit të Diplomacisë dhe Marrëdhënive Ndërkombëtare në Prishtinë dhe drejtor i Qendrës për Studime Shqiptare "Albanica" në Lubjanë si dhe zonjushën Ganimete Shala, përkthyes gjyqësore e gjuhës shqipe në Slloveni. Dhe në fund do doja të falënderoja Komunën e Koprit, në veçanti kryetarin e saj z. Boris Popoviq për mbështetjen e aktiviteteve tona, të cilat tani i zhvillojmë shumë më lehtë në objektin e ri të Shoqatës, i cili na u mundësua po nga kjo komunë".

Gjatë simpoziut u shpërnda edhe revista në të dy gjuhët sllovenisht-shqip:

FAMILJET FISNIKE SHQIPTARE NË KOPRIN E VENEZISË, në vitin jubilar të pallatit Bruti.

Delegacionin e Ministrisë së Diasporës dhe trupit diplomatik të Shqipërisë dhe Kosovës, iu rezervua një pritje e veçantë nga kryetari i Komunës së Koprit z. Boris Popoviq.

Nga Beqir Cikaqi
Shtator, 2015



të bukura të trashëgimisë arkitekturore të stilit Barok në Istria, pallatin Bruti, i cili ende shërben si dekorim i qytetit dhe luan një rol të rëndësishëm kulturor. Në këtë botim gjithashtu prezantohen të gjitha veprat letrare të ipeshkvi Agostino, ku përshkruan kohën e tij, pra, periudhën e prosperitetit më të madh të qytetit, kur ky zbukurohej me përfundimin e ndërtimit të katedrales, rimodelimin e baptisterisë së Shën Janez Krstnikut, ndërtimin e pallatit Bruti dhe renovimin e seminarit të ipeshkvisë. Publikimi përfundon me një përmbledhje sintetike, ku përshkruhen edhe disa familje tjera fisnike shqiptare të qytetit Kopër, gjë që për ne shqiptarët që sot jetojmë në Koper është shumë e rëndësishme. Shqiptarët jemi përmendur në Koper që në shekullin 13, me



*** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi *** Poezi ***

POETIT I KEMI BORXH*- Për Martin Camajn -*

Shkodra e lashtë, Shkodra e re.
O Martin Camaj,
Poezinë e ke hak...

Nga ujëvarat,
U riktheve,
Me "Lirikat mes dy motesh".

Bjeshkë në bjeshkë,
Për Temalin;
O sa shumë u përgjërove...

Vetëm kur foli zemra,
- Akoma e kam një varg,
Një varg tjetër të pathënë...

Profesori i Mynihut,
Shfaqet yll i Dukagjinit.

Atë botë flladi,
Ulet vrik nga Cukali
E përkëdhel kësulata e bardha...

Ç'është ky mall o Martin Camaj
- fol o burrë që deshe Alpet.

DHA KUSHTRIM RRUFEJA

...Dha kushtrim rrufeja,
Tufa vjen ngadalë ngadalë.
Delet i zë malli...

Gjithandej kopeja,
Ulet vrik nga mali,
Bash ne stan.

Sonte erdh tufa e fle...
Dhe një shoqe ka më pak.

O sa herë,
Bjeshkë në bjeshkë, maleve
Numëroj delet se aq dalin...

**MAL NË MALE BJESHKË
NË BJESHKË***- mjeshtrit të vargut popullor
Pjetër Gera -*

Shkruan këngë për çiftelinë,
O pjetër Gera:
- Të këndoftë zemra!

Dukagjinit shpi për shpi
I rrite vlerën...

Nga Tropoja, Shosh e Shalë,
Shllak, Toplanë e Tamarë,
Ty të thonë të rritët ndera.

Mal në mal e maje në maje,
Vezullojnë kësulata e bardha.
Më të bardha se vetë Alpet.

O Pjetër Gera,
Si bilbili gem më gem,
E këndojnë këngën tënde.

Në Veleçik e në Temal,
Ku gëlojnë kësulata e bardha,
Ndiheh mirë.

Gruemirë e në Kastrat,
Nga Mërturi e në Bushat,
Në Gjirokastër e në Berat.

Në Velipojë e në Oblikë,
Kënga jote është si dritë.

Dritës së re të Dukagjinit
I dhe jetë me çifteli
Si për besë e bujari.

O Pjetër Gera,
Ti me djelmohat e tjerë,
Jetofsh 100 pranvera.

HAJKU

- Vërtetë "ofshanë"
Dimri rrokullis gurët.
Gjurmë pas gjurme.

Fshehur ndër ferra.
Lulja e mërzitur.
E shpengoi Viti i Ri...

Faqen e malit
E mori mëndsh era.
Blegërijnë delet...

Janë bërë vajzat,
Në merak nga ëndërrat.
Kush i dashurom më?!

Mburret Cukali,
Dhe era lozonjare,
S'ndërron drejtimin...

Hajde dashuri,
Diçka dyshoi te Eva,
Pse i ndryshoi mendja...

Alarm zoglat.
Nga gurgullimat e lumit,
Tullumbace ujit.

O xixëllonjë...
Mos e fik dritën më,
Se erdhi pranvera.

Të keqen o çuna.
Mesdita në Tarabosh.
Hap kufinj të Shkodra.

Shkërmoqet uji.
Anës e anës bregut,
Vjen lakuriq lejleku.

Poeti **Lazer Preka**

LULE NË NJË SHKËMB

Atë ditë kur të pashë
Plotë lulëzim nënjë shkëmb
Menjëherë me vete thashë:
Mrekulli qënke tamam.

O e bukura ngjyra ylberi
Me rrenjë nënjë shkëmb
Ty të mora në breg të liqenit
Një merak të madh kam.

Të hoqa nga vendi me kujdes
Tan trupin tand e preka
Ishe e njomë si uji e vesa
Para teje i mahnitur mbeta!

Kanë kaluar disa vite
Kurdoherë të kam pranë
Në mes të librave o mike
Të ruaj si relike e radhë.

**NËN ROZAFËN
MADHËSHTORE**

Bashkëngjitur me një kodër
Nën Rozafën madhështore
Ditë e natë punove Shkodër
Me dhe kënetën e mbulove.

Kur vershonte Buna e Drini
Në mes të qytetit liqeni shkonte
Nga lindja tërbohej Kiri
Pjesën tjetër e pushtonte.

Vinte vera, shtohet vapa
Mbeturinat në moçal
Kudo miza e mushkonja
Qindra njerëz i çoj në spital.

Plepat, blini dhe dafinat
Lartë në Qiell e rritën shtatim
Në çdo hap Drandafilat
Përmbi bar ndaluan vrapin.

Ikte dita, afrohej nata
Dielli skuqej në perëndim
Dilte vjehrra, nusja, halla
Me shetit, me ba pushim.

Bashkë me 'to vogëlushtet
Në karroca e dorë për dorë
Në lëndinat "lepurushtet"
Fluturuan si zogjtë mbi borë.

Luigj Temali, Shkodër 17 Janar 2016

**KU U TRETEN GJITHE
KETO VITE?**

Ulem ne kompiuter ne vetmi
kujtoj vitet e mergimit
Large nder vite çoje memorien
valle ku shkuan dhe u treten
te gjithe keto vite ne mergim?
U largova 40 vjecar
flokete te nxire pa thinja ne balle
u largova, u treta dhe me dhe, e dere me dere
Ahe ku je o toka ime
pse keshtu ta ketheva shpinen?
Pse na ra ne ky mallkim
te na shkoj jeta ne mergim.
Ta disherojm token shqiptare
te disherojm shoket e femiris
te gjithe shpernda si zogjet shtegtar

Kane mbete shpiat qyqe te vetme
bien çatit e shemben muret
vdesin shoke dhe ilaka
varfnue vendi, kethye ne mjerim
hupe dashnia dhe respekti
sie keme pase na ndrshe vetit,
buke e kryp ja ndiem lezetin
kurse sot ka hy inati, shpirti keq
vllau per vllan!!!
Pse o Zot na ke gjykue
na si kombe mose me pa dite
a thue ashte mallkim prej zotit
apo gjama e bame prej robit....

VAJTIMI...

Ne shqiperi ne ate mallkuem vende
kercet pushka pa gja te keqe
vritet tjetri si zog pulet
pa mendue fare vrastari
se i lene femijet jetima
pa mendue se s'preket jeta,
Jeten Zoti ta ka fale, s'ka te drejt kushe me
ta marre.

Vaje e lote sote dere per dere
thue se ai vende nuk paska zote
s'paska shtet as qeveri
kete vlla vrasje per me ndale.
per meje thane VAJTIMIT ndale....
Bolle keme mete me shami te zeza
Parlamenti e qeveria
te lane shakat dhe budalliqet
me kethye ligjin e vdekjes.
Mej than ndal pushkes vrastare
ne se kerkojme te jemi shqiptar
te ldhim besen, bese prej burrit
ndale meje thane kokrres s' plumit,
vrasja ashte pune e shejtanit
Jeme shqiptare, bije te nji vatani
kem nji giak, keme nji flamur, kem nji zote
qe ne te besojme.
Beses, bese ti thomi shpejte
ti biem shqelme zokonit te zi
Vrasje ma te mos kete Shqipnia
te mose ndiejm ma vajtim nga pushka.

Gjin Musa

BABAIT TIM

Babi, s'është thjesht një baba,
por dera e një shtëpie të hapur.
vazhdimësi shkruar në ballë,
mbi flok', përkëdhelje e zgjatur.
Një baba, s'është thjesht një baba,
por fjalë me peshë të artë,
ky emër që s'njeh të këmbyer,
i vetmi çelës i saktë...
Një baba, është krahu në trup,
kujdesi në njeri shndërruar,
mendimi që s'flet, por të ndjek,
mirësi, njëher' në jetë dhuruar.

Lindita Vidhi

REDAKSIA**Kryeredaktor: Luigj Shyti****Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra,
Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja**

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA**Ma.di.sh** **Kimay**
PRODUCTION Produzione Giacche